

UDHËZIM
Nr. 2, datë 1.12.2021

**PËR PROCESIN E VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË MJAFTUESHMËRISË
SË LIKUIDITETIT**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 57, 58 dhe 66, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

UDHËZON:

Kërkesa të përgjithshme

1.1 Qëllimi i udhëzimit

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kërkesave mbikëqyrëse, në lidhje me strategjitë, politikat, proceset dhe sistemet për identifikimin, matjen, administrimin dhe monitorimin e rrezikut të likuiditetit, gjatë periudhave të përshtatshme kohore, përfshirë edhe ato ditore, në mënyrë që të sigurohen nivele të përshtatshme të rezervave të likuiditetit nga bankat.

1.2 Fusha e zbatimit

Kërkesat e këtij udhëzimi zbatohen për bankat dhe degët e bankave të huaja, mbi baza individuale dhe të konsoliduara.

1.3 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin për bankat, në rregulloren për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe në rregulloren për raportin e mbulimit me likuiditet.

2. Përveç sa parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të këtij udhëzimi, termat/përkufizimet e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) **“rreziku i financimit të likuiditetit”** është rreziku që banka, përgjatë një horizonti të caktuar kohor, do ta ketë të pamundur të shlyejë detyrimet, në kohën e duhur;

b) **“aftësia kundërbalancuese”** është aftësia e bankës për të mbajtur apo pasur akses në likuiditet të tepërt, në një horizont kohor afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, si përgjigje ndaj skenarëve të stresit;

c) **“likuiditeti brenda ditës”** (*intraday liquidity*) janë fondet, të cilat mund të aksesohen gjatë ditës së punës, zakonisht për të mundësuar bankat që të kryejnë pagesat në kohë reale;

d) **“rreziku i likuiditetit brenda ditës”** (*intraday liquidity risk*) është rreziku aktual ose i mundshëm që banka nuk mund të administrojë në mënyrë efektive nevojat e saj për likuiditet brenda ditës;

e) **“rreziku i financimit”** është rreziku që banka nuk mund të përmbushë detyrimet e saj financiare, si nevojat për pagesa dhe kolateral, në kohën e duhur, në periudhën afatmesme deri afatgjatë, në mënyrë të plotë, ose duke mos i rritur kostot e financimit në mënyrë të papranueshme;

f) **“rreziku i likuiditetit dhe financimit”** janë rreziqet e veçanta, të cilat, nëse materializohen, do të kishin një ndikim të konsiderueshëm prudencial mbi likuiditetin e bankës, përgjatë horizonteve të ndryshme kohore;

g) **“periudha afatshkurtër”** është një periudhë deri në 3 muaj, duke përfshirë atë ditore, dhe me një përqendrim të fortë në muajin e parë;

h) **“periudha afatmesme”** është një periudhë nga 3 deri në 12 muaj;

i) **“periudha afatgjatë”** është një periudhë mbi një horizont 1-vjeçar;

j) **“periudha e mbijetesës”** është periudha gjatë së cilës banka mund të vijojë të operojë në kushte stresi dhe sërish të përmbushë të gjitha pagesat në kohën e duhur;

k) **“plani i emergjencës së likuiditetit”** është bashkësia e politikave, procedurave dhe planeve të veprimit për t’iu përgjigjur ndërprerjeve të rënda të aftësisë së bankës për të financuar disa ose të gjitha aktivitetet e saj, në kohën e duhur dhe me një kosto të arsyeshme;

l) **“oreksi/toleranca ndaj rrezikut të likuiditetit”** është niveli i rrezikut të likuiditetit që banka është e gatshme të pranojë;

m) **“detyrimet me kohë specifike”** janë detyrimet të cilat duhet të shlyhen në një kohë të caktuar brenda ditës, ose të kenë një afat të pritshëm të shlyerjes brenda ditës.

1.4 Kërkesa të përgjithshme mbi mjaftueshmërinë e likuiditetit

Bankat sigurojnë në çdo kohë burimet e nevojshme të likuiditetit, të cilat janë të përshtatshme në aspektin cilësor dhe sasior, dhe bëjnë të mundur që ato (bankat) të mos ekspozohen ndaj rreziqeve të rëndësishme, të cilat sjellin mosshlyerjen e detyrimeve në kohën e tyre të maturimit. Bankat, me qëllim sigurimin e niveleve të përgjithshme të mjaftueshmërisë së likuiditetit, sigurojnë që:

a) burimet e tyre të likuiditetit të përmbajnë një rezervë të përshtatshme likuiditeti të aktiveve me cilësi të lartë, të lira nga çdo barrë apo detyrim; dhe

b) të ruajnë një profil financimi të kujdesshëm.

Bankat nuk përfshijnë në burimet e likuiditetit që llogariten në rezervat e likuiditetit, asnjë linjë emergjente të likuiditetit, që mund të jetë e disponueshme nga Banka e Shqipërisë (ose nga bankat e tjera qendrore, në rastin e filialeve/degëve të huaja të bankës).

Procesi i vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit (PVBML)

PVBML-ja përbëhet nga elementet e mëposhtme:

a) vlerësimi i rrezikut të likuiditetit;

b) vlerësimi i rrezikut të financimit;

c) administrimi i rrezikut të likuiditetit dhe të financimit;

d) vlerësimi i kërkesave shitesë të likuiditetit, sipas PVBML-së.

Vlerësimi i rrezikut të likuiditetit

Vlerësimi i rrezikut të likuiditetit është hapi i parë në kryerjen e PVBML-së. Banka identifikon dhe vlerëson rrezikun e saj të likuiditetit, bazuar në parametrat e përshkruar më poshtë në këtë udhëzim.

3.1 Nevojat afatshkurtra dhe afatmesme për likuiditet

Bankat vlerësojnë nevojat e tyre afatshkurtra dhe afatmesme për likuiditet, në kushte normale dhe kushte stresi. Në këto vlerësime, bankat marrin parasysh:

a) nevojat e bankës për likuiditet, në situata stresi, gjatë periudhave të ndryshme kohore (më pak se 30 ditë, midis 30 ditësh dhe 3 muajsh, si dhe mes 3 deri në 12 muajsh, dhe, specifikisht, ndikimin në nevojat e likuiditetit të bankës (flukset dalëse neto të parasë) të streseve të ashpra, por të mundshme, për të mbuluar goditjet specifike (*idiosyncratic*), ato në të gjithë tregun dhe goditjet e kombinuara;

b) madhësinë, vendndodhjen dhe monedhën e nevojave për likuiditet dhe, kur banka operon në monedha të ndryshme materiale, ndikimet e ndara të goditjeve në monedha të ndryshme, për të pasqyruar rrezikun e konvertueshmërisë së monedhës;

c) rreziqet ndaj kundërpasive me shumicë (*wholesale*), në lidhje me zërat e bilancit dhe përqendrimet e financimit, dhe duke marrë parasysh veprimet që banka mund të ndërmarrë për të ruajtur reputacionin/ekskluzivitetin (*franchise*) e saj;

d) rreziqet që rrjedhin nga flukset e parave të kushtëzuara/zërat jashtë bilancit (për shembull, linjat e kredisë, thirrjet për marzh (*margin calls*)¹) dhe aktivitetet (për shembull, mbështetja me likuiditet, përtej detyrimeve kontraktuale, për entitetet, me qëllim të posaçëm (SPV) të pakonsoliduara), duke marrë në konsideratë veprimet që banka mund të ndërmarrë për të ruajtur reputacionin/ekskluzivitetin (*franchise*) e saj;

¹ Një *margin call* i referohet, në mënyrë specifike, kërkesës së një *broker*-i që një investitor të depozitojë para ose letra me vlerë shitesë në llogari, në mënyrë që ajo të arrijë sërish vlerën minimale, të njohur si marzhi i mirëmbajtjes.

e) flukset hyrëse dhe dalëse bruto dhe neto. Kur ka flukse hyrëse dhe dalëse shumë të larta, mund të ekzistojë rreziku që flukset hyrëse të mos merren në momentin e parashikuar;

f) rreziqet ndaj kundërpartive me pakicë (*retail*), duke marrë parasysh veprimet që banka mund të ndërmarrë për të ruajtur reputacionin/ekskluzivitetin (*franchise*) e saj; dhe

g) rreziku që rreziqet e tepërta, në profilin e financimit afatmesëm dhe afatgjatë, do të ndikojnë negativisht sjelljen e kundërpartive, që lidhen me pozicionin e likuiditetit afatshkurtër.

3.2 Administrimi i likuiditetit gjatë ditës

3.2.1 Banka administron në mënyrë aktive pozicionet e saj ditore të likuiditetit dhe çdo rrezik të lidhur me to, me qëllim që të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e pagesës dhe të shlyerjes, në kohën e duhur, si në kohë normale, ashtu edhe në kohë stresi. Objektivat kryesorë të bankës, në procesin e administrimit të likuiditetit gjatë ditës, janë: a) identifikimi dhe prioriterizimi i detyrimeve me kohë specifike dhe i detyrimeve të tjera kritike, për t'i përmbushur ato në kohën e pritshme; dhe b) shlyerja e detyrimeve të tjera më pak kritike, sa më shpejt të jetë e mundur. Banka, në vlerësimin e rrezikut të saj ditor të likuiditetit, merr parasysh të paktën gjashtë elemente operacionale të administrimit të rrezikut të likuiditetit:

a) aftësinë për të matur flukset e pritshme hyrëse dhe dalëse bruto ditore të likuiditetit, për t'i paraprirë, kur është e mundur, kohës kur ndodhin këto flukse dhe për të parashikuar intervalin e mungesave të mundshme të financimit neto, që mund të shfaqen në momente të ndryshme gjatë ditës;

b) aftësinë për të monitoruar pozicionet ditore të likuiditetit, kundrejt aktiviteteve të parashikuara dhe burimeve të disponueshme (gjendjet, kapaciteti ditor i mbetur i kreditimit, kolaterali i disponueshëm);

c) marrëveshjet për të siguruar financim të mjaftueshëm ditor, për të përmbushur objektivat e saj ditorë, nga burime të ndryshme, si banka qendrore, bankat korrespondente ose bankat kujdestare;

d) aftësinë për të administruar dhe për të përdorur kolateralin, kur është e nevojshme për të siguruar fonde brenda ditës;

e) aftësinë për të administruar kohën e flukseve dalëse të likuiditetit, në përputhje me objektivat e saj ditorë;

f) aftësinë për të administruar ndërprerjet e paparashikuara të flukseve të saj ditore të likuiditetit. Banka, me qëllim minimizimin e ndërprerjeve të tilla të mundshme, pasqyron vlerësimet ditore të likuiditetit, në *stress testing* dhe në planet e financimit të emergjencës.

3.2.2 Politikat, procedurat dhe sistemet e bankës mbështesin realizimin e objektivave operacionale, në të gjithë tregjet financiare dhe monedhat në të cilat banka kryen pagesa të konsiderueshme. Mjetet dhe burimet e përdorura nga banka përshtaten me modelin e biznesit dhe rolin e bankës në sistemin financiar, si dhe me mënyrën se si ajo i zhvillon aktivitetet e saj në një treg të veçantë (p.sh., nëpërmjet pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në një sistem pagese ose shlyerjeje, apo nëpërmjet bankave korrespondente ose kujdestare) dhe me faktin nëse ofron shërbime korrespondente ose të kujdestarisë dhe lehtësira ditore kredie për bankat, kompanitë ose sistemet e tjera.

3.3 Mjaftueshmëria e rezervës së likuiditetit dhe aftësia kundërbalancuese

3.3.1 Bankat vlerësojnë mjaftueshmërinë e rezervës së tyre të likuiditetit dhe aftësinë kundërbalancuese për të përmbushur nevojat e tyre mujore të likuiditetit, si dhe nevojat e likuiditetit në horizonte të ndryshme kohore, potencialisht deri në 1 vit, përfshirë ato njëditore (*overnight*). Ky vlerësim merr parasysh:

a) rezervat e drejtpërdrejta të disponueshme të likuiditetit ose periudhat e mbijetesës (funksionimit normal) së bankës, sipas skenarëve të ndryshëm të stresit;

b) aftësinë e përgjithshme kundërbalancuese, në dispozicion të bankës, gjatë gjithë periudhës së skenarit përkatës të stresit;

c) karakteristika, të tilla si ashpërsia dhe kohëzgjatja e skenarëve dhe periudhave të ndryshme të stresit, të marra parasysh në vlerësimin e nevojave për likuiditet të bankës;

d) vlerën e aktiveve që do të duhet të likuidohen gjatë periudhave përkatëse kohore;

e) faktin nëse rezerva aktuale e likuiditetit dhe aftësia kundërbalancuese, përfshirë cilësinë e aktiveve likuide, janë në përputhje me tolerancën ndaj rrezikut të likuiditetit të bankave; dhe

f) klasifikimin dhe cilësinë e aktiveve likuide, siç specifikohet në rregulloren e Bankës së Shqipërisë nr. 27, datë 28.3.2019, për Raportin e Mbulimit me Likuiditet dhe në rregulloren nr. 37, datë 2.12.2020, për Raportin Neto të Financimit të Qëndrueshëm.

3.3.2 Bankat janë në gjendje të kthejnë në para (*cash*) aktivet e tyre likuide, në kohë për të përmbushur nevojat e tyre të likuiditetit, gjatë një periudhe stresi. Për të siguruar këtë, banka:

- a) teston aksesin e saj në treg, duke shitur ose riblerë në mënyrë periodike;
- b) shmang përqendrimet e larta që mund të paraqesin një rrezik të mbivlerësimit të rezervës së likuiditetit dhe aftësisë kundërbalancuese;
- c) siguron që aktivet në rezervën e likuiditetit janë të lira nga çdo barrë apo detyrim, nën kontrollin e personelit përkatës dhe lehtësisht të disponueshëm, për qëllime të administrimit të likuiditetit;
- d) siguron që parashikimi/planifikimi i aktiveve likuide, sipas monedhave, është në përputhje me shpërndarjen e nevojave të likuiditetit, sipas monedhës;
- e) kur banka ka marrë hua aktive likuide, merr parasysh aktivet që duhet të kthejë gjatë një periudhe afatshkurtër të stresit të likuiditetit, që do të thotë se banka nuk do t'i ketë më në dispozicion këto aktive për të përmbushur flukset dalëse të stresuara, duke marrë parasysh efektin neto të transaksionit; dhe
- f) merr parasysh vlerën e mundshme të lehtësive të angazhuara të likuiditetit, të disponueshme nga Banka e Shqipërisë ose bankat qendrore në juridiksione të tjera ku banka mund të operojë. Këto lehtësira përfshihen në aftësinë kundërbalancuese, vetëm në masën e lejuar nga Banka e Shqipërisë/bankat e tjera qendrore.

Vlerësimi i rrezikut të qenësishëm/të brendshëm të financimit

4.1 Profili i financimit të bankës

4.1.1 Profili i financimit të bankës, përfshirë mospërputhjet kontraktuale dhe të sjelljes, si afatmesme, ashtu edhe afatgjata, është i përshtatshëm në lidhje me modelin e saj të biznesit, strategjinë dhe tolerancën e saj ndaj rrezikut. Banka, gjatë vlerësimit të profilit të saj të financimit, merr parasysh:

- a) shkallën në të cilën janë përmbushur, në mënyrë të përshtatshme, detyrimet e saj afatmesme dhe afatgjata, me anë të një sërë instrumentesh të qëndrueshme të financimit dhe nëse mospërputhjet e saj aktuale, gjatë periudhave përkatëse kohore, janë brenda kufijve të pranueshëm, në lidhje me modelin e biznesit të bankës;
- b) çdo *gap* midis profilit të dëshiruar të financimit dhe profilit aktual të financimit të bankës;
- c) faktorët rregullatorë dhe kontraktualë, që ndikojnë në karakteristikat e sjelljes së ofruesve të financimit (p.sh., rregulloret në lidhje me *clearing*-un, dorëzaninë, skemat e sigurimit të depozitave etj., pasi ato mund të ndikojnë në sjelljen e ofruesve të financimit), veçanërisht kur ka ndryshime materiale ose ndryshime midis juridiksioneve në të cilat banka vepron; dhe
- d) faktin që transformimi i maturitetit do të çojë në një nivel të caktuar mospërputhjes, por siguron që këto të qëndrojnë brenda kufijve të administrueshëm dhe të kontrollueshëm, për të parandaluar dështimin e modelit të biznesit gjatë periudhave të stresit ose ndryshimeve në rrethanat e tregut.

4.1.2 Bankat mbajnë parasysh që mangësitë e mundshme, të cilat vijnë nga profili i tyre i financimit, të tilla si mospërputhjet e maturitetit që shkelin kufijtë e pranueshëm, përqendrimet e tepërta të burimeve të financimit, nivelet e tepërta të aktiveve, që nuk janë të lira nga çdo barrë apo detyrim, ose financimi i papërshtatshëm apo i paqëndrueshëm i aktiveve afatgjata, mund të çojnë në një rritje të papranueshme të kostos së financimit për bankën. Bankat marrin parasysh:

- a) rrezikun e financimit, të rinovuar me norma më të larta interesi, kur ekziston një varësi e tepërt nga burime të veçanta të financimit;

b) rrezikun e rritjes së nevojave të financimit të bankës ose të burimeve të financimit që e bëjnë bankën të perceptohet sikur ka një profil më të rrezikshëm, veçanërisht kur ka pak gjasa që ato kosto më të larta të transferohen automatikisht te klientët; dhe

c) rritjen e nivelit të aktiveve, që nuk janë të lira nga çdo barrë apo detyrim (të barrësuar) mbi kufijtë e pranueshëm, të cilët me gjasa do të zvogëlonin aksesin dhe do të rrisnin çmimin e financimit të pagarrantuar.

4.2 Qëndrueshmëria e profilit të financimit

4.2.1 Bankat mbajnë një profil financimi të qëndrueshëm. Bankat, gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë së profilit të tyre të financimit, marrin në konsideratë faktorë që mund të ulin qëndrueshmërinë e profilit të financimit, në lidhje me llojin dhe karakteristikat e aktiveve dhe pasiveve. Në këtë aspekt, bankat marrin parasysh:

a) faktin se disa kategori specifike të aktiveve do të jenë më të rëndësishme se të tjerat, për bankën dhe/ose sistemin;

b) mospërputhjen strukturore të maturitetit, midis aktiveve dhe pasiveve në monedha të ndryshme të rëndësishme, kur është e zbatueshme, si dhe në tërësi, dhe se si mospërputhjet e monedhave që u mbivendosen mospërputhjeve strukturore të maturitetit, ndikojnë në rrezikun e përgjithshëm të qëndrueshmërisë së profilit të financimit; dhe

c) parametrat e duhur strukturore të financimit (të përshtatshëm për modelin e biznesit të bankës). Shembuj të parametrave strukturore të financimit mund të përfshijnë raportin kredi/depozita, *gap*-in e financimit të klientit dhe shkallën e maturimit të rregulluar në bazë të sjelljes (nga të cilat parametri i raportit neto të financimit të qëndrueshëm është një shembull i veçantë).

4.2.2 Bankat vlerësojnë rreziqet ndaj qëndrueshmërisë së profilit të financimit, që rrjedhin nga përqendrimet në burimet e financimit, dhe marrin parasysh në vlerësim respektivisht:

a) përqendrimet në aspekte të ndryshme, veçanërisht dhe kur është e zbatueshme: llojin e instrumenteve të financimit të përdorura, tregjet specifike të financimit, kundërpasitë e vetme ose të lidhura dhe rreziqe të tjera të përqendrimit, që mund të ndikojnë aksesin në financim në të ardhmen (duke u përqendruar në tregjet dhe instrumentet që lidhen me profilin e financimit afatgjatë dhe duke vërejtur se pikëpamja e tyre mbi rrezikun e përqendrimit në profilin e likuiditetit afatshkurtër mund të jetë me rëndësi); dhe

b) rrezikun që aktivet, të cilat nuk janë të lira nga çdo barrë apo detyrim, mund të kenë një efekt negativ mbi oreksin e tregut për borxhin e pagarrantuar të bankës (në kontekstin e karakteristikave specifike të tregut (tregjeve), ku banka vepron dhe të modelit të saj të biznesit).

Faktorët për këtë vlerësim mund të përfshijnë:

- shumën totale të aktiveve që nuk janë të lira nga çdo barrë apo detyrim dhe/ose të marra hua në raport me bilancin;

- disponueshmërinë e aktiveve të lira (aktivet që janë të lira nga çdo barrë apo detyrim, por që mund të barrësohen), veçanërisht kur merren parasysh në lidhje me financimin total të pagarrantuar me shumicë;

- nivelin e mbikolateralizimit² në raport me kapitalin; dhe

- implikimet e nivelit të mbikolateralizimit mbi skemën e sigurimit të depozitave, nëse banka është në kushtet e paaftësisë paguese.

4.3 Lehtësia për të aksesuar tregun

4.3.1 Bankat janë të vetëdijshme për aksesin e tyre aktual në treg dhe kërcënimet aktuale dhe të ardhshme ndaj këtij aksesit në treg. Bankat, në përcaktimin e aksesit në treg në situata stresi, marrin parasysh faktorët e mëposhtëm:

² Mbikolateralizimi i referohet masës deri në të cilën vlera e aktiveve të përdorura për të përfutur financim të garantuar tejkalon vlerën nominale të financimit të përfutur (p.sh., në qoftë se janë përdorur 120 lekë të aktiveve për të përfutur një financim të garantuar prej 100 lekësh, mbikolateralizimi është 20 lekë).

a) çdo informacion për të cilin ato (bankat) janë në dijeni, përfshirë informacionin nga vetë banka, që tregon se banka ka kërkesa të larta mbi tregje të veçanta ose kundërparti (përfshirë bankat qendrore) që janë të rëndësishme për të, në lidhje me aftësinë e këtyre tregjeve/kundërpative;

b) çdo ndryshim të rëndësishëm ose të papritur në emetimin e borxhit, për të cilin banka bëhet e vetëdijshme në çdo treg të rëndësishëm (përfshirë edhe tregjet në monedha të rëndësishme). Bankat, gjithashtu, vlerësojnë nëse çdonjëri prej ndryshimeve të tilla, vjen si pasojë e zgjedhjeve strategjike të bankës ose nëse ato janë shenja të aksesit të zvogëluar në treg;

c) rreziku që lajmet rreth bankës mund të ndikojnë negativisht në treg (perceptimi/besimi) dhe si pasojë edhe në aksesin e saj në treg (lajme të tilla mund të jenë ose të mos jenë ende të njohura për tregun); dhe

d) sinjalizimet/paralajmërimet se rreziqet afatshkurtra të likuiditetit (p.sh., kur rreziku afatshkurtër i likuiditetit vlerësohet i lartë) mund të zvogëlojnë aksesin që banka ka në tregjet e saj kryesore të financimit.

4.4 Ndryshimi i parashikuar në rreziqet e financimit, bazuar në planin e financimit të bankave

Banka është e vetëdijshme për kufizimet e planit të saj të financimit. Banka vlerëson ndryshimin e parashikuar në rreziqet e financimit, bazuar në planin e financimit. Ky vlerësim merr parasysh:

a) mënyrën se si plani i financimit të bankës, kur zbatohet plotësisht, do të ndikojë mbi rreziqet e saj të financimit (këtu duhet pasur parasysh se zbatimi i planit të financimit mund të rrisë ose të ulë rreziqet në profilin e financimit); dhe

b) realizueshmërinë e planit të financimit.

Administrimi i rrezikut të likuiditetit dhe i rrezikut të financimit

5.1 Oreksi/toleranca ndaj rrezikut të likuiditetit dhe ndaj rrezikut të financimit

i. Këshilli drejtues i bankës përcakton oreksin/tolerancën ndaj rrezikut të likuiditetit dhe ndaj rrezikut të financimit të bankës dhe e dokumenton atë në mënyrë të përshtatshme. Banka siguron që oreksi/toleranca e saj ndaj rrezikut të likuiditetit dhe ndaj rrezikut të financimit janë të përshtatshme me strategjinë e saj të biznesit dhe pasqyrojnë gjendjen e saj financiare dhe kapacitetin e financimit. Deklarata e oreksit/tolerancës ndaj rrezikut të likuiditetit përcakton qartë kohëzgjatjen dhe llojin e streseve që banka synon të përballojë.

ii. Këshilli drejtues i bankës përcakton oreksin/tolerancën e bankës ndaj rrezikut të likuiditetit, bazuar në objektivat e biznesit, drejtimin strategjik dhe oreksin/tolerancën e përgjithshme ndaj rrezikut. Oreksi/toleranca do të pasqyrojë gjendjen financiare të bankës, rolin e saj në sistemin financiar, kapacitetin e saj të financimit dhe do të sigurojë që ajo të miradministrojë likuiditetin në kushte normale, në mënyrë të tillë që të jetë në gjendje të përballojë një periudhë të zgjatur stresi. Oreksi/toleranca ndaj rrezikut formulohet në mënyrë të tillë që të gjitha nivelet e drejtimit të kuptojnë qartësisht *trade-off*-in ndërmjet rreziqeve dhe fitimeve.

iii. Oreksi/toleranca ndaj rrezikut të likuiditetit dhe ndaj rrezikut të financimit u komunikohet të gjitha linjave relevante/përkatëse të biznesit. Kjo zbërthehet/detajohet në formën e kufijve të përshtatshëm, të cilët mund të përfshijnë kufijtë e *gap*-eve ose kufijtë e përqendrimit, sipas monedhës, sipas burimeve të financimit, përbërjes së rezervës së likuiditetit dhe pozicionit strukturor të likuiditetit të bankës.

iv. Oreksi/toleranca ndaj rrezikut të likuiditetit rishikohet çdo vit, me qëllim që të pasqyrojë ndryshimet që mund të ndodhin në gjendjen financiare të bankës, aftësinë e financimit dhe rolin e saj në sistemin financiar.

5.2 Kuadri organizativ, politikat dhe procedurat

i. Banka, me qëllim përmbushjen e kërkesës për mjaftueshmërinë e likuiditetit, ka krijuar strategji, politika, procese dhe sisteme të forta, që i mundësojnë asaj (bankës) të identifikojë, masë, administrojë dhe monitorojë rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun e financimit, gjatë një bashkësie të përshtatshme horizontesh kohore, duke përfshirë atë ditor, në mënyrë që të sigurojë

ruajtjen e niveleve të përshtatshme të rezervave të likuiditetit dhe një profil të duhur financimi. Këto strategji, politika, procese dhe sisteme përshtaten sipas linjave të biznesit, monedhave, degëve të bankës dhe personave juridikë të grupit bankar/financiar dhe përfshijnë mekanizmat e duhur të shpërndarjes së kostove të likuiditetit, përfitimeve dhe rreziqeve.

ii. Strategjitë, politikat, proceset dhe sistemet për të përmbushur kërkesën për mjaftueshmërinë e likuiditetit janë në përputhje me kompleksitetin, profilin e rrezikut dhe fushën e veprimit të bankës, oreksin/tolerancën ndaj rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të financimit të përcaktuar nga drejtimi i bankës dhe pasqyrojnë rëndësinë e bankës, në çdo vend ku ajo ushtron aktivitetin e saj.

iii. Banka, duke marrë parasysh natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj, ka profile të rrezikut të likuiditetit dhe profile të rrezikut të financimit, të cilat janë në përputhje dhe nuk tejkalojnë profilet e nevojshme për një sistem që funksionon mirë dhe të qëndrueshëm.

iv. Banka harton politikat e administrimit të rrezikut, për të përcaktuar qasjen e saj ndaj aktiveve që nuk janë të lira nga çdo barrë apo detyrim, si dhe procedurat dhe kontrollet që sigurojnë se rreziqet e lidhura me administrimin e kolateralit dhe aktivet që nuk janë të lira nga çdo barrë apo detyrim, të identifikohen, monitorohen dhe administrohen në mënyrë të përshtatshme.

v. Banka ka një kuadër organizativ të përshtatshëm për funksionet e administrimit, matjes dhe kontrollit të rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të financimit, me burime të mjaftueshme njerëzore dhe teknike, për të zhvilluar dhe për të zbatuar këto funksione dhe për të kryer detyrat e kërkuara për monitorimin e tyre. Kuadri organizativ përmban:

a) kontrollin e sistemeve dhe të proceseve të kontrollit, dhe të monitorimit të rrezikut të likuiditetit nga funksione të pavarura të kontrollit;

b) mbulimin nga funksionet e administrimit, matjes dhe kontrollit të rrezikut të likuiditetit në të gjithë bankën dhe, veçanërisht, në të gjitha fushat ku mund të ndërmerret, zbutet ose monitorohet rreziku i likuiditetit;

c) një grup dokumentesh të politikës së likuiditetit dhe të financimit, të përshtatshme për promovimin e sjelljes së kujdesshme nga stafi i bankës dhe lejimin e funksionimit efikas të funksioneve të kontrollit; dhe

d) krijimin e politikave dhe të procedurave të brendshme të përshtatshme dhe të shkruara për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe të financimit, si dhe mjaftueshmërinë e kuadrit të administrimit të rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të financimit të bankës.

vi. Bankat ruajnë aksesin e përshtatshëm në tregjet e tyre të rëndësishme të financimit. Për këtë qëllim, banka:

a) teston aksesin në treg në mënyrë periodike;

b) zhvillon marrëdhënie të forta me ofruesit e fondeve, për të ulur rrezikun e zvogëlimit të aksesit të saj në treg; dhe

c) vërteton që ajo (banka) do të vazhdojë të ketë akses të vazhdueshëm në treg në kohë stresi (edhe pse mund të jetë më e kushtueshme për bankën ta realizojë këtë, në kohë të tilla).

5.3 Identifikimi, matja, administrimi, monitorimi dhe raportimi i rrezikut

5.3.1 Bankat kanë një kuadër dhe sisteme TI-je për identifikimin dhe për matjen e rrezikut të likuiditetit dhe të financimit, në përputhje me madhësinë, kompleksitetin, tolerancën ndaj rrezikut dhe kapacitetin e rrezikut. Banka, në veçanti:

a) zbaton metoda të përshtatshme për planifikimin e flukseve të parasë, për një bashkësi të përshtatshme horizontesh kohore, duke supozuar situata normale të veprimtarisë dhe situata stresi, dhe ,në mënyrë gjithëpërfshirëse, ndërmjet nxitësve materialë të rrezikut;

b) përdor supozimet dhe metodologjitë e duhura kryesore, të cilat rishikohen rregullisht, duke njohur ndërveprimin midis rreziqeve të ndryshme (të kredisë, të tregut etj.), që rrjedhin nga zërat brenda dhe jashtë bilancit;

c) përfshin të gjithë personat juridikë, degët dhe filialet përkatëse materiale, në juridiksionin në të cilin banka ushtron veprimtarinë e saj; dhe

d) kupton aftësinë e saj për të aksesuar instrumentet financiare, kudo që ato mbahen, duke pasur parasysh çdo kufizim ligjor, rregullator dhe operacional për përdorimin e tyre, përfshirë, për shembull, pamundësinë për të pasur akses tek aktivet, për shkak se ato nuk janë të lira nga çdo barrë apo detyrim, gjatë periudhave të ndryshme kohore.

5.3.2 Bankat kanë një kuadër raportimi të përshtatshëm për rrezikun e likuiditetit dhe të financimit. Bankat:

a) përcaktojnë kriteret e raportimit të miratuar nga drejtoria/drejtuesit ekzekutivë, duke përcaktuar fushën, mënyrën dhe shpeshtësinë e raportimit të rrezikut të likuiditetit dhe të financimit, si dhe personat përgjegjës për përgatitjen e raporteve;

b) sigurojnë që sistemet e informacionit, administrimi i informacionit dhe rrjedhat e brendshme të informacionit, që mbështesin administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe të financimit, janë të përshtatshëm dhe të dhënat dhe informacioni i përdorur janë të kuptueshëm për audiencën e synuar, të saktë dhe të përdorshëm (p.sh., në kohën e duhur, jo tepër komplekse, brenda fushës së duhur etj.); dhe

c) sigurojnë që raportet dhe dokumentacioni specifik që përmbajnë informacione gjithëpërfshirëse dhe lehtësisht të aksesueshme mbi rrezikun e likuiditetit, të dorëzohen rregullisht të marrësit e duhur (të tillë si Këshilli Drejtues, drejtoria/drejtuesit ekzekutivë ose komiteti i aktiv-pasiveve).

5.3.3 Bankat vlerësojnë mjaftueshmërinë e procesit për matjen e rrezikut ditor të likuiditetit dhe sigurojnë:

a) monitorimin dhe kontrollin në mënyrë të përshtatshme të flukseve të parasë dhe të burimeve likuide të disponueshme, për të përmbushur kërkesat ditore dhe për të parashikuar se kur realizohen flukset e parasë gjatë ditës; dhe

b) kryerjen e *stress testing* specifik, të përshtatshëm për operacionet ditore.

5.3.4 Bankat kanë një grup treguesish, për sa i përket pozicionit të likuiditetit dhe të financimit, që janë të përshtatshëm për modelin e biznesit, natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së bankës.

i. Treguesit mbulojnë në mënyrë të përshtatshme dobësitë kryesore strukturore të financimit të bankës, duke mbuluar aspektet e mëposhtme, sipas rastit:

a) shkallën e varësisë nga një treg i vetëm ose nga një numër tepër i vogël i tregjeve/kundërpartive;

b) “palëvizshmërinë” e burimeve të financimit dhe të faktorëve nxitës të sjelljes;

c) përqendrimin e instrumenteve të veçanta;

d) përqendrimin e aktiviteteve në monedha të ndryshme;

e) përqendrimet kryesore të maturiteteve dhe *gap*-eve të maturitetit në periudhë afatgjatë.

ii. Treguesit dokumentohen në mënyrë të përshtatshme, rishikohen periodikisht, përdoren si *input*-e për të përcaktuar tolerancën ndaj rrezikut të bankës, pjesë e raportimit të drejtimit të bankës, si dhe përdoren për vendosjen e kufijve operacionalë.

5.4 *Stress testing* specifik i likuiditetit të bankës

i. Banka kryen rregullisht *stress test*-e për një sërë skenarësh stresi afatshkurtër dhe të zgjatur, specifikë të bankës dhe për të gjithë tregun (individualisht dhe të kombinuara) për të identifikuar burimet e tensionit të mundshëm të likuiditetit dhe për të siguruar që ekspozimet aktuale qëndrojnë në përputhje me tolerancën e përcaktuar të bankës ndaj rrezikut të likuiditetit. Banka vlerëson ndikimet e mundshme të stresit në flukset e parave të bankës, pozicionin e likuiditetit, përfitueshmërinë dhe aftësinë paguese të saj.

ii. Banka merr në konsideratë skenarë alternativë mbi pozicionet e likuiditetit dhe mbi teknikat e zbutjes së rrezikut dhe rishikon, të paktën çdo vit, supozimet ku bazohen vendimet që lidhen me pozicionin e financimit.

iii. *Stress test*-e zhvillohen si mbi baza të konsoliduara, ashtu edhe mbi baza individuale. Banka vlerëson nëse testet shtesë janë të nevojshme për subjekte individuale (p.sh., filialet dhe degët)

brenda grupit, që janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të rëndësishme të likuiditetit. Testet marrin në konsideratë implikimin e skenarëve në horizonte të ndryshme kohore, përfshirë edhe ato ditore.

iv. Banka, gjatë hartimit të skenarëve të stresit, merr parasysh natyrën e biznesit, veprimtaritë dhe dobësitë e saj (bankës), në mënyrë që skenarët të përfshijnë financimin kryesor dhe rreziqet e likuiditetit të tregut, ndaj të cilave ekspozohet banka.

v. Banka merr në konsideratë specifiku lidhjen midis reduktimeve në likuiditetin e tregut dhe kufizimeve në financimin e likuiditetit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për bankat e mëdha/me rëndësi sistemike ose që mbështeten kryesisht në tregje specifike të financimit.

vi. Banka merr në konsideratë ndikimin e mundshëm të skenarëve specifikë të bankës, të mbarë tregut dhe të kombinuar e alternativë, periudhat e ndryshme kohore dhe nivelet e ndryshme të kushteve të stresit.

vii. Banka ka një qasje konservative, kur vendos supozimet e *stress testing*. Bazuar në llojin dhe ashpërsinë e skenarit, këto supozime pasqyrojnë burime të ndryshme rreziqesh, që mund të ndikojnë potencialisht pozicionin e likuiditetit dhe të financimit të bankës. Lista ilustruese e faktorëve relevantë të rrezikut për *stress testing* të likuiditetit paraqitet si më poshtë:

a) faktorët që ndikojnë aftësinë e bankave për të likuiduar aktivet ose për t'i kthyer ato në para (*cash*), përmes marrëveshjeve të shitjes ose të riblerjes, që mund të ndryshojnë në situata stresi. Këta mund të përfshijnë aksesin në treg, *haircut*-et, afatet kohore, çmimet, kapacitetin operacional ose pranueshmërinë;

b) kohëzgjatja për të cilën banka do të dëshironte t'i rezistonte stresit të likuiditetit, duke pasur parasysh oreksin/tolerancën e saj ndaj rrezikut (përtej periudhës 30-ditore të zbatueshme sipas rregullores për Raportin e Mbulimit me Likuiditet);

c) tërheqja e financimit me pakicë (përtej normave të zbatueshme të tërheqjes, sipas rregullores për Raportin e Mbulimit me Likuiditet), duke marrë parasysh faktorë të ndryshëm, si mbulimi i garancisë, maturiteti, ndjeshmëria e normës së interesit, lloji i klientit, lloji i produktit, madhësia e depozitës ose kanali përmes të cilit janë ndikuar depozitat;

d) disponueshmëria e burimeve të garantuara dhe të pagaruara të financimit me shumicë, në varësi të llojit dhe të vendndodhjes gjeografike të kundërpartisë, nivelit të prioritetit *senior* të kreditorit, natyrës së marrëdhënies së bankës me kundërpartinë, llojit të kolateralit themelor (nëse është e zbatueshme) dhe shpejtësisë së flukseve dalëse. Rreziku i shkurtimit të kohëzgjatjes së mbetur të financimit duhet vlerësuar, gjithashtu;

e) korrelacioni midis tregjeve të financimit ose efektivitetit të diversifikimit ndërmjet burimeve të financimit, duke marrë parasysh llojin e instrumentit, tregjet, monedhën, strukturën e afatit të detyrimit, kundërpartinë dhe aksesin në treg, sipas rastit;

f) thirrjet për marzh shtesë dhe kërkesat për kolateral shtesë për transaksionet derivative;

g) kohëzgjatja e mbetur e financimit, duke marrë parasysh dobësitë brenda strukturës së afatit për shkak të ngjarjeve të jashtme, të brendshme ose kontraktuale (ku ofruesi i financimit ka opsione *call*);

h) pretendime të kushtëzuara dhe më konkretisht, tërheqje të mundshme të linjave të miratuara për palët e treta ose filialet, degët apo zyrën qendrore të bankës;

i) disponueshmëria e linjave të kushtëzuara të ofruara për bankën;

j) llojet e kolateralit që mund të kërkohen dhe shpejtësia e flukseve dalëse, sipas rastit, ndikohen nga vlerësimi i kredisë – në aspektin e flukseve dalëse kontraktuale dhe flukseve dalëse, që përcaktohen nga sjellja, ardhur si pasojë e uljeve të vlerësimit të kredisë, me madhësi të ndryshme;

k) vlerësimi i konvertueshmërisë së valutave dhe aksesit në tregjet e këmbimit valutor, në aspektin e flukseve dalëse të stresuara, sipas monedhave individuale dhe kohëzgjatjes së mbetur, kur është e përshtatshme. Bankat vlerësojnë se si mund të financohen mungesat e likuiditetit në një treg të stresuar me akses të dëmtuar në tregjet e këmbimit valutor dhe humbje të konvertueshmërisë;

l) aftësia për të transferuar likuiditetin ndërmjet subjekteve, sektorëve dhe kufijve, duke marrë parasysh kufizimet dhe detyrimet ligjore, rregullatore, operacionale dhe të zonës kohore. Bankat vlerësojnë mbështetjen brenda grupit që ka të ngjarë të jetë e disponueshme në situatë stresi ose ndikimin e paaftësisë së një subjekti të grupit, për të shlyer kreditë në kohën e duhur, kur është e përshtatshme. Ky vlerësim përfshin shqyrtimin e kufizimeve ekzistuese ligjore, rregullatore dhe operacionale për transferimet e mundshme të likuiditetit dhe të aktiveve të lira nga çdo barrë apo detyrim midis subjekteve, linjave të biznesit, vendeve dhe monedhave;

m) aksesit në lehtësirat e bankës qendrore;

n) aftësia operacionale e bankës për të kthyer në para (*cash*) aktivet;

o) veprimet korrigjuese të bankës dhe disponueshmëria e dokumentacionit të nevojshëm dhe e ekspertizës, e përvojës operacionale për t'i kryer ato, duke marrë parasysh ndikimin e mundshëm reputacional, gjatë kryerjes së këtyre veprimeve;

p) vlerësimet e rritjes së ardhshme të bilancit, duke marrë parasysh se si mund të sillen në situatë stresi bilancet e planifikuara ose të parashikuara, dhe nëse oreksi/toleranca e bankës ndaj rrezikut do të shkelet.

viii. Banka merr në konsideratë mjete të ndryshme për zbutjen e rrezikut të likuiditetit, duke përfshirë një sistem kufijsh dhe rezervash likuiditeti, në mënyrë që të jetë në gjendje të përballojë një sërë ngjarjesh të ndryshme stresi dhe një strukturë të larmishme financimi dhe të aksesit në burimet e financimit. Këto mjete rishikohen rregullisht nga banka.

ix. Banka konsideron në *stress test*-et e saj reagimin e mundshëm të sjelljes së pjesëmarrësve të tjerë të tregut ndaj ngjarjeve të stresit të tregut dhe shkallën në të cilën një përgjigje e zakonshme mund të amplifikojë lëvizjet e tregut dhe të përkeqësojë vështirësitë e tij. Banka, gjithashtu, merr parasysh ndikimin e mundshëm të sjelljes së saj mbi atë të pjesëmarrësve të tjerë të tregut.

x. Drejtoria/drejtuesit ekzekutivë rishikon/jnë skenarët dhe supozimet e *stress test*-it, si dhe rezultatet e *stress test*-it. Drejtoria/drejtuesit ekzekutivë integron/jnë rezultatet e procesit të *stress testing* në procesin e planifikimit strategjik të bankës (p.sh., duke ndryshuar/korrigjuar përbërjen e aktiv-pasiveve) dhe praktikatat e përditshme të administrimit të rrezikut të bankës (p.sh., përmes monitorimit të flukseve të ndjeshme të parasë ose zvogëlimit të kufijve të përqendrimit). Rezultatet e *stress test*-eve merren parasysh në përcaktimin e kufijve të brendshëm.

xi. Drejtoria/drejtuesit ekzekutivë vendos/in se si të përfshijë rezultatet e *stress test*-eve në vlerësimin dhe planifikimin për mungesat e mundshme të financimit në planin e financimit të emergjencës së bankës. Drejtoria/drejtuesit ekzekutivë, në masën që deficitet e parashikuara të financimit janë më të mëdha (ose tepëricat e parashikuara të financimit janë më të vogla) se ato të parashikuara në tolerancën ndaj rrezikut të likuiditetit të bankës, konsideron nëse do të rregullojë pozicionin e saj të likuiditetit ose të forcojë planin e emergjencës së bankës, duke u konsultuar me këshillin drejtues.

xii. Banka raporton rezultatet e *stress test*-eve të likuiditetit në Bankën e Shqipërisë, në kohën e duhur.

5.5 Kuadri i kontrollit të brendshëm të rrezikut të likuiditetit

5.5.1 Banka ka një kuadër të fortë dhe gjithëpërfshirës të kufijve të brendshëm dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe masa mbrojtëse të shëndosha, për të zbutur ose për të kufizuar rrezikun e likuiditetit, në përputhje me tolerancën e saj ndaj rrezikut. Banka siguron, në veçanti që:

a) kuadri i kufijve të brendshëm dhe i sistemit të kontrollit të jetë i përshtatshëm për kompleksitetin, madhësinë dhe modelin e biznesit të bankës dhe të pasqyrojë faktorët e ndryshëm materialë të rrezikut të likuiditetit, siç janë mospërputhjet e maturitetit, mospërputhjet e valutave, transaksionet derivative, zërat jashtë bilancit dhe rreziku i likuiditetit ditor;

b) të zbatohet kufij të përshtatshëm dhe sisteme monitorimi, që janë në përputhje me tolerancën e saj ndaj rrezikut të likuiditetit dhe që përdorin rezultatet e *stress test*-eve të likuiditetit;

c) kufijtë e rrezikut të rishikohen rregullisht nga organet kompetente të bankës dhe t'u komunikohen në mënyrë të qartë të gjitha linjave përkatëse të biznesit;

d) të ketë procedura të qarta dhe transparente, në lidhje me mënyrën se si miratohen dhe rishikohen kufijtë individualë të rrezikut të likuiditetit;

e) të ketë procedura të qarta dhe transparente, në lidhje me mënyrën se si monitorohet përputhshmëria me kufijtë individualë të rrezikut të likuiditetit dhe si trajtohen shkeljet e kufijve (përfshirë përshkallëzimin e qartë dhe procedurat e raportimit); dhe

f) kuadri i kufijve të brendshëm dhe sistemi i kontrollit të brendshëm të ndihmojë bankën për të siguruar disponueshmërinë e një strukture të diversifikuar të financimit dhe të aktiveve likuide të mjaftueshme dhe të aksesueshme.

5.5.2 Banka zbaton një sistem të qëndrueshëm të transferimit të çmimit, si pjesë e kuadrit të kontrollit të rrezikut të likuiditetit. Banka siguron, në veçanti që:

a) sistemi i transferimit të çmimit të fondeve të bankës të mbulojë të gjitha veprimtaritë e rëndësishme të bankës;

b) sistemi i transferimit të çmimit të fondeve të bankës të përfshijë të gjitha kostot, përfitimet dhe rreziqet përkatëse të likuiditetit;

c) sistemi i transferimit të çmimit të fondeve të bankës të lejojë drejtorinë/drejtuesit ekzekutivë të bankës të japë stimujt e duhur për administrimin e rrezikut të likuiditetit;

d) metodologjia e transferimit të çmimit dhe kalibrimi i saj të rishikohet dhe përditësohet në mënyrë të përshtatshme, duke pasur parasysh madhësinë dhe kompleksitetin e bankës;

e) sistemi i transferimit të çmimit dhe metodologjia e tij t'i komunikohen stafit përkatës; dhe

f) politika e bankës, për përfshirjen e metodologjisë së transferimit të çmimit të fondeve në kuadrin e brendshëm të çmimeve, të përdoret për vlerësimin dhe vendimin mbi transaksionet me klientët (kjo përfshin të dyja anët e bilancit, p.sh., dhënien e kredive dhe marrjen e depozitave).

5.5.3 Banka ka kontrolle të përshtatshme sa i takon rezervës së aktiveve likuide. Banka siguron në veçanti që:

a) kuadri i kontrollit të mbulojë monitorimin në kohë të rezervës së aktiveve likuide, përfshirë cilësinë e aktiveve, përqendrimin e tyre, disponueshmërinë e menjëhershme të subjekti i grupit, duke përdorur aktivet për të mbuluar rreziqet e likuiditetit dhe çdo pengesë për shndërrimin e tyre në para në kohë; dhe

b) të ketë një politikë të përshtatshme për monitorimin e kushteve të tregut që mund të ndikojnë në aftësinë e saj (bankës) për të shitur ose për t'ë riblerë sa më shpejt aktivet në treg.

5.6 Planet e emergjencës së likuiditetit

i. Banka siguron dhe mban një rezervë të aktiveve likuide të cilësisë së lartë, të lira nga çdo barrë apo detyrim për t'u mbajtur si garanci ndaj një sërë skenarësh të stresit të likuiditetit, madje dhe ata që përfshijnë humbjen ose dëmtimin e fondeve të pagarantuara dhe të atyre të garantuara në dispozicion.

ii. Banka rregullon strategjitë, politikat e brendshme dhe kufijtë e brendshëm mbi rrezikun e tregut dhe rrezikun e financimit, si dhe zhvillon një plan efektiv të emergjencës së likuiditetit, duke marrë parasysh rezultatin nga skenarët alternativë, të përmendur në paragrafin 5.4.

iii. Plani i emergjencës së likuiditetit përfshin strategjitë për të adresuar barrën apo detyrimin e emergjencës (nevojën për kolateral shtesë që lind nga kushtet e pafavorshme të tregut) që rezulton nga ngjarjet përkatëse të stresit, përfshirë uljet e vlerësimit të kredisë së bankës, rënien e vlerës së drejtë të aktiveve të lënë peng, zhvlerësimin e monedhave dhe rritjen e kërkesave për marzhe.

iv. Plani i emergjencës i likuiditetit përcakton strategjitë e përshtatshme dhe masat e duhura të zbatimit, me qëllim që të adresojë mungesat e mundshme të likuiditetit. Këto plane testohen të paktën çdo vit, përditësohen në bazë të rezultatit të skenarëve alternativë të përcaktuar në paragrafin 5.4, si dhe raportohen dhe miratohen nga drejtoria/drejtuesit ekzekutivë të bankës, në mënyrë që politikat dhe proceset e brendshme të rregullohen në mënyrë të përshtatshme.

v. Përdorimi i këtyre aktiveve për përfitimin e financimit nuk duhet të ketë pengesa ligjore, rregullatore ose operationale. Banka ndërmerr paraprakisht hapat e nevojshëm operationale për të siguruar që planet e emergjencës së likuiditetit mund të zbatohen në mënyrë të menjëhershme,

duke përfshirë mbajtjen e kolateralit në dispozicion për financimin nga banka qendrore. Kjo përfshin mbajtjen e kolateralit kur është e nevojshme në monedhën e vendeve të treta, ndaj të cilëve banka ka ekspozime.

vi. Plani i emergjencës shpjegon marrëveshjet e drejtimit të brendshëm për aktivizimin dhe mirëmbajtjen e tij.

vii. Banka ka një kuadër të treguesve të paralajmërimit të hershëm të likuiditetit, me gjasa efektive në mundësimin e bankës që të identifikojë në kohën e duhur rrethanat e tregut që po përkeqësohen dhe të përcaktojë me shpejtësi veprimet që duhet të ndërmerren;

viii. Plani i emergjencës parashikon qartë të gjitha burimet e rëndësishme (të mundshme) të financimit, duke përfshirë shumat e parashikuara të disponueshme për burimet e ndryshme të likuiditetit dhe kohën e parashikuar si të nevojshme për të marrë fonde prej tyre.

ix. Plani i emergjencës përmban masat në përputhje me strategjinë e përgjithshme të rrezikut të bankës dhe tolerancën e saj ndaj rrezikut të likuiditetit.

x. Plani i emergjencës specifikon supozimet në lidhje me rolin e financimit të bankës qendrore në planin e emergjencës së likuiditetit të bankës dhe përfshin parashikimet e mëposhtme të bankës, mbi:

a) disponueshmërinë aktuale dhe të ardhshme të burimeve alternative të mundshme të financimit, të lidhur me programet e huadhënies së bankës qendrore;

b) llojet e lehtësirave të kreditimit, kolateralin e pranueshëm dhe procedurat operationale për aksesin në fondet e bankës qendrore; dhe

c) rrethanat në të cilat do të nevojitej financimi i bankës qendrore, shuma e kërkuar dhe periudha për të cilën ndoshta do të kërkohej një përdorim i tillë i financimit të bankës qendrore.

5.7 Planet e financimit

5.7.1 Plani i financimit është i realizueshëm dhe i përshtatshëm në lidhje me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin, aktivitetet aktuale dhe të parashikuara, si dhe profilin e likuiditetit dhe të financimit të bankës. Plani i financimit:

a) është i fortë/i qëndrueshëm, për sa i përket aftësisë së tij për të mbështetur veprimtaritë e parashikuara të biznesit të bankës, sipas skenarëve të pafavorshëm;

b) është i përshtatshëm, duke pasur parasysh veprimtaritë dhe modelin e biznesit të bankës;

c) mbështet çdo përmirësim të kërkuar ose të dëshiruar në profilin e financimit të bankës;

d) integrohet me planin e përgjithshëm strategjik të bankës;

e) është në përputhje me tolerancën e saj (bankës) ndaj rrezikut të likuiditetit;

f) përmban strategji të ndryshme dhe procedura të qarta të administrimit, për zbatimin në kohë të ndryshimeve të strategjisë;

g) dokumentohet saktë dhe i komunikohet të gjithë stafit përkatës; dhe

h) përfshihet në veprimtaritë e përditshme të bankës, veçanërisht në procesin e vendimmarrjes së financimit; dhe

i) është i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm, duke pasur parasysh likuiditetin aktual dhe pozicionet e financimit të bankës, si dhe ecurinë e pritshme të tyre.

5.7.2 Banka, përveç konsideratave të parashikuara në pikën 5.7.1, në raportin e PVBML-së:

a) është në gjendje të shpjegojë arsyen përse plani i financimit është i realizueshëm dhe ku qëndrojnë dobësitë e tij;

b) ka një politikë për të përcaktuar se cilat dimensione të financimit dhe cilat tregje janë domethënëse për bankën (dhe nëse është e përshtatshme);

c) siguron që horizonti kohor i parashikuar për zhvendosjen drejt një profili tjetër financimi, nëse kërkohet ose dëshirohet, është i arsyeshëm, duke pasur parasysh se mund të ketë rreziqe të përfshira nëse zhvendosja drejt një gjendjeje përfundimtare është shumë e shpejtë ose shumë e ngadaltë; dhe

d) është në gjendje të rikonsolidojë/rishikojë planin e financimit, në përputhje me të dhënat e paraqitura në formatin e planit të financimit të paraqitur në Bankën e Shqipërisë.

5.7.3 Banka përcakton proceset për monitorimin e ekzekutimit të planit të financimit dhe reagimin ndaj devijimeve në kohën e duhur. Banka:

a) siguron përditësimet për drejtorinë/drejtuesit ekzekutivë, në lidhje me statusin aktual të ekzekutimit të planit të financimit;

b) përcakton masa alternative të zmbropsjes (të kthimit në gjendjen e duhur), që do të zbatohen nëse ka ndryshime në kushtet e tregut; dhe

c) përcakton politikën në lidhje me rishikimin dhe përditësimin e rregullt të planit të financimit, kur financimi i mbledhur në realitet ndryshon në masë të konsiderueshme nga plani i financimit.

5.8 Administrimi i kolateralit

i. Banka administron në mënyrë aktive pozicionet e kolateralit dhe dallon ndërmjet aktiveve të bllokuar si garanci dhe aktiveve të lira nga çdo barrë apo detyrim, të cilat janë të disponueshme në çdo kohë, në mënyrë të veçantë gjatë situatave të emergjencës për likuiditet.

ii. Banka merr, gjithashtu, në konsideratë personin juridik ku ndodhen aktivet, vendin ku janë të regjistruara aktivet nga ana ligjore, në një regjister apo në një llogari, ashtu si edhe pranueshmërinë e tyre, dhe njëkohësisht monitoron se si aktivet mund të përdoren në kohën e duhur.

5.9 Administrimi i barrës apo detyrimit mbi aktivin

i. Këshilli drejtues i bankës harton dhe miraton politika të administrimit të rrezikut, për të përcaktuar qasjen e tij kundrejt barrës apo detyrimit mbi aktivin, ashtu si edhe procedura dhe kontrole për të siguruar që rreziqet e shoqëruara me administrimin e kolateralit dhe barrën apo detyrimin mbi aktivin, identifikohen, monitorohen dhe administrohen në mënyrën e duhur. Këto politika marrin në konsideratë modelin e biznesit të bankës, juridiksionet ku ushtron veprimtarinë banka, veçoritë e tregjeve të financimit dhe situatën makroekonomike.

ii. Banka përfshin në planet e saj të emergjencës strategjitë për të adresuar barrën apo detyrimin mbi aktivin, që rezulton nga ngjarje stresi me rëndësi, që do të thotë goditje të mundshme, ndonëse me pak gjasa për të ndodhur, duke përfshirë uljen (*downgrade*) e vlerësimit të cilësisë së kredisë (*credit rating*) së bankës, zhvlerësimin e aktiveve të bllokuar si garanci dhe rritjet në kërkesat e marzhit.

iii. Banka disponon një kuadër të përgjithshëm monitorues, i cili u ofron drejtuesve ekzekutivë të saj informacion në kohën e duhur, mbi:

a) nivelin, ecurinë dhe llojet e barrës apo të detyrimit mbi aktivin dhe burimet përkatëse të barrës apo të detyrimit, të tillë si financimi i garantuar apo transaksione të tjera;

b) shumën, ecurinë dhe cilësinë e kredisë së aktiveve të lira nga çdo barrë apo detyrim, por që mund të ngarkohen me barrë apo detyrim, duke specifikuar vëllimin e aktiveve të disponueshme për t'u vendosur si barrë apo detyrim; dhe

c) shumën, ecurinë dhe llojet e barrës apo detyrimit shtesë që rezultojnë nga skenarët e stresit (barrë apo detyrim emergjence).

Për qëllimet e këtij udhëzimi, një aktiv duhet të trajtohet si i ngarkuar me barrë apo detyrim, nëse ai i nënshtrohet çfarëdolloj forme marrëveshjeje për të garantuar, kolateralizuar apo përmirësuar vlerësimin e cilësisë së kredisë së një transaksioni.

5.10 Administrimi i likuiditetit për subjektet e grupit bankar/financiar dhe sipas linjave të biznesit, vendeve dhe monedhave të huaja

Banka, gjatë administrimit të ekspozimeve ndaj rrezikut të likuiditetit dhe të financimit përkatës, merr në konsideratë:

a) kufizimet ekzistuese ligjore, rregullatore dhe operationale, për transferimet e mundshme të likuiditetit dhe të aktiveve të lira nga çdo barrë apo detyrim ndërmjet subjekteve të grupit bankar;

b) çdo kufizim tjetër mbi transferueshmërinë e likuiditetit dhe aktiveve të lira nga çdo barrë apo detyrim, ndërmjet linjave të biznesit, vendeve dhe monedhave të huaja; dhe

c) strategjitë dhe masat për zbutjen/reduktimin e mundësisë së rënies/dëmtimit të reputacionit, që mund të përfshijnë, por jo të kufizohen, në vendosjen dhe ruajtjen e komunikimit

efektiv me kundërpartitë, agjencitë e vlerësimit të kredisë dhe palët e tjera të interesit në kohën kur dalin në pah problemet e likuiditetit, si dhe të nevojës së zbatimit të planeve të emergjencës së financimit për të gjithë grupin, duke ruajtur rezervat e likuiditetit dhe duke përdorur burime të shumëfishta të financimit.

5.11 Diversifikimi i financimit dhe aksesit në treg

Banka:

a) përcakton një strategji financimi që ofron diversifikim efektiv të burimeve dhe të maturitetit të mbetur të financimit;

b) ruan një prani të vazhdueshme në tregjet e saj të përzgjedhura të financimit dhe marrëdhënie të forta me ofruesit e financimit, me qëllim nxitjen e diversifikimit efektiv të burimeve të financimit;

c) mat rregullisht aftësinë e saj për të siguruar/mbledhur me shpejtësi fonde nga çdo burim; dhe

d) identifikon faktorët kryesorë që ndikojnë aftësinë e saj për të siguruar/mbledhur fonde dhe për të monitoruar nga afër ata faktorë, për të siguruar që vlerësimet e aftësisë për të mbledhur fonde mbeten të vlefshëm.

5.12 Shpërndarja e kostove të rrezikut të financimit dhe të rrezikut të likuiditetit

i. Banka përfshin kostot, përfitimet dhe rreziqet e likuiditetit në vendosjen e çmimeve të brendshme, në matjen e performancës dhe në procesin e miratimit të produktit të ri, për të gjitha aktivitetet me rëndësi të biznesit (si në bilanc, ashtu edhe jashtë bilancit), duke siguruar konsistencë/lidhje të incentivave (stimujve) për ndërmarrjen e rrezikut, sipas linjave individuale të biznesit me ekspozimet e bankës ndaj rrezikut të likuiditetit.

ii. Këshilli drejtues i bankës harton një Politikë të Transferimit të Fondeve (PTF), në përshtatje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë operacionale të bankës dhe me profilin e rrezikut të likuiditetit, si dhe siguron zbatimin e përshtatshëm të tij.

iii. PTF-ja përfshin rreziqet e financimit dhe rreziqet e nevojës (emergjencës) së likuiditetit.

iv. PTF-ja zbatohet në mënyrë konsistente dhe transparente, për sa u përket metodologjive për identifikimin dhe shpërndarjen e kostove dhe përfitimeve, sipas veprimtarive të ndryshme të bankës.

v. Bankat (drejtoria) i paraqesin në mënyrë periodike këshillit drejtues një raport mbi PTF-në.

5.13 Administrimi i rezervës së likuiditetit

5.13.1 Kthimi periodik në para i rezervës së likuiditetit për të testuar tregun

Bankat kthejnë në para në mënyrë periodike një kampion (përqindje) përfaqësues të mjaftueshëm të vendosjeve të tyre në rezervave të likuiditetit, të ndryshme nga ato që ponderohen me peshë zero, në përputhje me dispozitat e rregullores për mjaftueshmërinë e kapitalit. Bankat kanë akses të menjëhershëm në vendosjet e tyre në rezervat e likuiditetit dhe sigurojnë që të mos ketë kufizime ligjore ose operacionale për kthimin në para të rezervave të likuiditetit, në çdo moment, gjatë periudhës së stresit prej 30 ditësh kalendarike. Në mënyrë të veçantë, ndërkohë që klasifikimi i letrave me vlerë në kategori të ndryshme kontabël përbën për bankën një vendim, bazuar në modelin e biznesit, bankat, të cilat i vendosin rezervat e likuiditetit në portofolin e letrave me vlerë të investimit (*held-to-maturity portfolio*), janë në gjendje të provojnë që kjo nuk dëmton aftësinë e tyre për t'i kthyer këto aktive në para, përmes tregjeve të marrëveshjeve të riblerjes dhe shitjeve të drejtpërdrejta, gjatë periudhave të stresit. Bankat marrin në konsideratë faktorë me rëndësi, të tillë si thellësia e tregut³, numri i kundërpartive të rregullta, xhiroja individuale e bankës dhe aksesit shtesë në treg gjatë periudhave të stresit, nevoja për të rinovuar (*rollover*) transaksionet afatshkurtra të marrëveshjeve të riblerjes dhe kohët e shlyerjes etj. Bankat ofrojnë prova të të dhënave të përdorura, gjatë vlerësimeve të bëra në kuadër të PVBML-së së tyre.

³ “Thellësia e tregut” është aftësia e tij për të përthithur kërkesa për transaksione, pa ndikime të konsiderueshme mbi çmimin e letrës me vlerë.

5.13.2 Diversifikimi i rezervës së likuiditetit

i. Bankat vendosin kufij dhe kontrole të brendshëm të përshtatshëm, me qëllim sigurimin e një diversifikimi të përshtatshëm të rezervës së tyre të likuiditetit. Kjo duhet të jetë e mjaftueshme për të provuar se aftësia e tyre për të kthyer në para rezervën e likuiditetit, gjatë një harku të shkurtër kohor, pa humbje të konsiderueshme të vlerës, nuk ndikohet (komprometohet) nga ekspozimi ndaj një faktori të përbashkët të rrezikut. Banka e Shqipërisë pret që bankat e mëdha/me rëndësi sistematike të marrin në konsideratë madhësinë absolute të vendosjeve të tyre në rezerva të likuiditetit, si dhe të jenë në gjendje t'i kthejnë ato në para, pa ndikuar (komprometuar) si shpejtësinë e shitjes, ashtu edhe çmimin. Bankat e mëdha/me rëndësi sistematike marrin në konsideratë edhe ndikimin e veprimeve të tyre mbi tregun në përgjithësi dhe mbi stabilitetin financiar.

ii. Bankat mbajnë në konsideratë modelin e tyre të biznesit, kur përcaktojnë nivelin e përshtatshëm të diversifikimit në rezervën e tyre. Në mënyrë të veçantë, bankat marrin në konsideratë rrezikun që mbajtja e një aktivi të caktuar e bën atë (aktivin) jolikuid, pikërisht në momentin kur vetë bankës i nevojitet të tërheqë rezervën e saj, për shembull, për arsye se, si banka dhe aktivi janë të ekspozuar ndaj një faktori të përbashkët të rrezikut. Nga ana tjetër, bankat, gjithashtu, marrin në konsideratë nëse përzgjedhja e aktiveve nga ana e tyre është e përshtatshme, në kuadrin e aftësisë së tyre për të administruar në mënyrë të përshtatshme rrezikun e aktiveve në fjalë, si dhe për të aksesuar tregun përkatës të marrëveshjeve të riblerjes apo të shitjes.

Përcaktimi i kërkesave shtesë për likuiditet, në kuadër të PVBML-së

6.1 Bankat mbajnë parasysh, gjatë identifikimit të kërkesave shtesë për likuiditet, në terma të rezervës më të lartë të likuiditetit dhe të Financimit të Disponueshëm të Qëndrueshëm, për të përmbushur kërkesat minimale (shtylla 1), përfshirë edhe kërkesat e PVBML-së (shtylla 2), konsideratat e mëposhtme:

a) çdo rrezik të identifikuar nga banka dhe që nuk mbulohet nga rregulloret mbi Raportin e Mbulimit me Likuiditet dhe Raportin Neto të Financimit të Qëndrueshëm (RNFQ);

b) rrezikun ditor të likuiditetit mbi vlerën mesatare;

c) nevojat për mbulimin e rrezikut të likuiditetit përtej periudhës 30-ditore;

d) nënvlerësimin e flukseve dalëse nga faktorët rregullatorë të tërheqjes;

e) mbivlerësimin e flukseve hyrëse nga faktorët rregullatorë;

f) mbivlerësimin e vlerës së realizueshme të rezervës së likuiditetit ose të aftësisë kundërbalancuese⁴;

g) mungesën e disponibilitetit, në aspektin operacional, të aktiveve likuide (aktive të padisponueshme për shitje/letra me vlerë jo të vendosjes, aktive që janë të lira nga çdo barrë apo detyrim etj.);

h) përqendrimet specifike të aftësisë kundërbalancuese dhe/ose të financimit sipas kundërpartisë dhe/ose produktit/llojit;

i) mungesa financimi në intervale specifike maturimi, në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë;

j) mbulim i përshtatshëm i mungesave të financimit, sipas monedhave të huaja të ndryshme; dhe

k) rezultate të tjera me rëndësi të *stress-test*-eve mbikëqyrëse të likuiditetit.

6.2 Kërkesa shtesë për rezervën e likuiditetit, e përcaktuar nga banka, raportohet si një shtesë mbi kërkesën minimale (shtylla 1) për RML, si vijon:

Ilustrim i raportimit të kërkesave shtesë për RML në përputhje me PVBML-në

1	Rezerva e likuiditetit e shtyllës 1	200 lekë
---	-------------------------------------	----------

⁴ “Aftësia kundërbalancuese” është aftësia e bankës për të mbajtur apo pasur akses në likuiditet të tepërt në një horizont kohor afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, si përgjigje ndaj skenarëve të stresit.

2	Flukset hyrëse të shtyllës 1	400 lekë
3	Flukset dalëse të shtyllës 1	300 lekë
4	Rezerva e kërkuar e likuiditetit për të përmbushur RML-në minimale	$(\max [(25\% \cdot 300), (300-400)] \cdot 100\%$ $= (\max (75, -100) \cdot 100\%$ $= 75$
5	RML i shtyllës 1 (aktual)	$200 / (\max [(25\% \cdot 300), (300-400)]$ $= 200 / (\max (75, -100)$ $= 200 / 75$ $= 267\%$
6	Flukse dalëse shtesë, të vlerësuara në kuadër të PVBML-së (për shembull, për shkak të zbatimit të faktorëve më të lartë të tërheqjes)	80 lekë
7	Ulje në flukset hyrëse të vlerësuara në kuadër të PVBML-së	40 lekë
8	Flukset dalëse të rishikuara	$(300+80) = 380$ lekë
9	Flukset hyrëse të rishikuara	$(400-40) = 360$ lekë
10	Rezerva totale e likuiditetit të kërkuar, në kuadër të PVBML-së për të përmbushur RML-në prej 100%, duke konsideruar flukset dalëse neto të rishikuara	$(\max (25\% \cdot 380, 380-360) \cdot 100\%$ $= (\max (95, 20)$ $= 95$ lekë
11	Shtesë në rezervën totale të likuiditetit të kërkuar (95 lekë) mbi bazën e nevojës për të zbatuar kritere më shtrënguese të pranueshmërisë (për shembull, nevoja për të zbatuar një <i>haircut</i> më të madh se sa ai që kërkohej nga rregullorja nr. 27, datë 28.3.2019, “Për raportin e mbulimit me likuiditet”)	- Supozim, <i>haircut</i> mesatar i ponderuar që zbatohet = 30% - Rezerva minimale e likuiditetit që nevojitet me një <i>haircut</i> prej 30% = $95 / 70\% = 136$ - <i>Haircut</i> i kërkuar i përcaktuar nga banka, në kuadër të PVBML-së = 35% - Rezerva minimale e likuiditetit që nevojitet me një <i>haircut</i> prej 35% = $95 / 65\% = 146$ - Rezervë shtesë likuiditeti që nevojitet nëse do të zbatohet një <i>haircut</i> më i madh = $146 - 136 = 10$ lekë
12	Kërkesa totale për rezervë likuiditeti në kuadër të PVBML-së	$95 + 10 = 105$ lekë
13	Kërkesa shtesë për rezervë likuiditeti	$105 - 75 = 30$ lekë
14	Kërkesa shtesë për RML-në	$30 / 75 = 40\%$
15	Kërkesa minimale për RML-në në kuadër të PVBML-së	140%
16	RML ekzistues	267%
17	Pjesa që tejkalon RML-në	$267 - 140 = 127\%$

Drejtimi i PVBML-së

i. Këshilli drejtues i bankës ka përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e PVBML-së. Shkalla e detajimit dhe gjithëpërfshirja e PVBML-së janë në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e bankës, si dhe me oreksin/tolerancën e saj ndaj rrezikut të likuiditetit. Këshilli drejtues siguron që PVBML-ja të jetë plotësisht e integruar me praktikatat e përgjithshme të administrimit të rrezikut të bankës, strategjinë e bankës, vendimet e biznesit dhe planifikimin e likuiditetit. Bankat përcaktojnë vetë përmbajtjen, shtrirjen dhe thellësinë e vlerësimit të brendshëm, duke zbatuar parimin e proporcionalitetit, ndonëse ky udhëzim ka si qëllim të ofrojë orientime mbi PVBML-në.

ii. Këshilli drejtues rishikon PVBML-në të paktën një herë në vit.

iii. PVBML-ja zbatohet mbi baza vjetore dhe dokumentohet nga banka.

iv. PVBML-ja identifikon masat e parashikuara nga banka në planet e emergjencës së likuiditetit që ajo (banka) do të zbatojë në rast se nevojitet.

Qëndrueshmëria e PVBML-së

i. Politika, proceset, *input*-et dhe modelet e PVBML-së, janë në përpjesëtim me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e aktiviteteve të bankës. PVBML-ja rezulton në një vlerësim dhe ruajtje të qëndrueshme të një niveli të mjaftueshëm të kapitalit të brendshëm dhe likuiditetit të

brendshëm, me qëllim monitorimin e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet ose mund të ekspozohet banka, si dhe për procesin e vendimarrjes, duke përfshirë edhe rastet e situatave të stresit.

ii. Metodologjitë dhe supozimet e përdorura nga banka janë të përshtatshme dhe konsistente sipas rreziqeve, janë të bazuara në të dhëna (*input-e*) empirike të qëndrueshme, përdorin parametra të kalibruar në mënyrë robuste dhe përdoren njësoj si për matjen e rrezikut të likuiditetit dhe për administrimin e likuiditetit.

iii. Përkufizimi dhe përbërja e burimeve të brendshme të disponueshme të likuiditetit, të marra në konsideratë nga banka për PVBML-në, janë konsistentë/në përputhje me rreziqet e matura nga banka dhe të pranueshëm (*eligible*) për përlogaritjen e rezervave të likuiditetit.

iv. Shpërndarja/alokimi i burimeve të brendshme të disponueshme të likuiditetit, ndërmjet linjave të biznesit ose subjekteve (personave juridikë), pasqyron në mënyrë të përshtatshme rrezikun ndaj të cilit, secili prej tyre është i ekspozuar ose mund të ekspozohet, merr siç duhet në konsideratë çdo kufizim ligjor ose operacional të transferueshmërisë së këtyre burimeve.

Efektiviteti i PVBML-së

Bankat e përdorin PVBML-në në proceset e tyre të vendimarrjes dhe të administrimit (siç janë p.sh. vendosja e kufijve, matja e performancës etj.). PVBML-ja miratohet nga këshilli drejtues i bankës, i cili siguron që PVBML-ja të vlerësohet bazuar në parimin e perspektivës (*forward-looking*) dhe të jetë konsistent me planet e likuiditetit dhe planet strategjike.

Banka harton dhe miraton politika dhe procedura, si dhe mjetet për të lehtësuar proceset e mëposhtme:

i. identifikimi i qartë i funksioneve dhe/ose i komiteteve të krijuara nga këshilli drejtues, të cilat janë përgjegjëse për elementet e ndryshme të PVBML-së (siç janë, për shembull, modelimi dhe përcaktimi nga ana sasiore, kontrolli i brendshëm dhe validimi, monitorimi dhe raportimi, përshkallëzimi i problemeve etj.);

ii. përlogaritja e burimeve të likuiditetit, vlerësuar mbi parimin e perspektivës (*forward-looking basis*) (duke përfshirë rastin e skenarëve të supozuar të stresit), në lidhje me strategjinë e përgjithshme ose transaksionet e konsiderueshme;

iii. shpërndarja dhe monitorimi i burimeve të likuiditetit, sipas linjave të biznesit dhe llojeve të rrezikut (për shembull, kufijtë e rrezikut të përkufizuar për linjat e biznesit, subjektet ose rreziqet individuale janë konsistente/në përputhje me objektivin e sigurimit të mjaftueshmërisë së përgjithshme të burimeve të brendshme të likuiditetit të bankës);

iv. raportimi periodik dhe i shpejtë i mjaftueshmërisë së likuiditetit te këshilli drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë (në mënyrë të veçantë, shpeshtësia e raportimit është e mjaftueshme, në lidhje me zhvillimin e rreziqeve dhe vëllimin e veprimtarisë, rezervat e brendshme ekzistuese dhe procesin e brendshëm të vendimarrjes, për të lejuar drejtimin e bankës që të përcaktojë veprime ndreqëse përpara se sa të vihet në rrezik mjaftueshmëria e likuiditetit); dhe

v. ndërgjegjësimi dhe veprimi nga ana e këshillit drejtues ose e drejtuesve ekzekutivë, në rastet kur strategjia e biznesit dhe/ose transaksione individuale të konsiderueshme mund të jenë në mospërputhje me PVBML-në dhe me burimet e brendshme të disponueshme të likuiditetit.

Gjithëpërfshirja e PVBML-së

i. PVBML-ja zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme dhe proporcionale për të gjitha linjat e biznesit dhe subjektet (personat juridikë), në lidhje me identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut.

ii. PVBML-ja mbulon të gjitha rreziqet materiale, pavarësisht nga fakti nëse rreziku vjen nga subjektet që nuk janë pjesë e grupit të konsoliduar (entitete me qëllim të posaçëm (*Special Purpose Vehicle – SPV*), *special-purpose entities (SPE)*).

Raporti i PVBML-së

Bankat i paraqesin çdo vit Bankës së Shqipërisë një raport të PVBML-së, i cili dokumenton PVBML-në e tyre për vitin e mbyllur financiar. Raporti përgatitet në formatin e specifikuar në aneksin 1 të udhëzimit dhe i paraqitet Bankës së Shqipërisë, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti.

Kërkesat për informacion mbi PVBML-në

Bankat paraqesin informacionin e specifikuar në aneksin 2, së bashku me raportin e PVBML-së, për t'i mundësuar Bankës së Shqipërisë kryerjen e vlerësimeve mbikëqyrëse të mëposhtme, si pjesë e PRVM-së (shtylla 2):

- a) vlerësimin e qëndrueshmërisë, efektivitetit dhe gjithëpërfshirjes së kuadrit të PVBML-së;
- b) vlerësimin e nivelit të detajimit, besueshmërisë, të qenët të kuptueshëm dhe krahasueshmërisë së çdo kërkesë shtesë për likuiditet të përcaktuar nga bankat; dhe
- c) si një burim shtesë informacioni për vlerësimin e rreziqeve të likuiditetit dhe të financimit, si dhe të mjaftueshmërisë së likuiditetit.

Informacioni i kërkuar mund të paraqitet në brendësi të raportit të PVBML-së ose të ofrohet si një shtojcë e raportit të PVBML-së, si të vlerësohet më e përshtatshme. Në rastin kur i gjithë informacioni ose pjesë të tij, paraqiten në brendësi të raportit të PVBML-së, banka ofron një plan të qartë të seksioneve të raportit, që përmban informacionin, në lidhje me secilin nga seksionet e aneksit 2.

Masat mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë rishikon dhe vlerëson PVBML-në, me qëllim sigurimin e niveleve të mjaftueshme të likuiditetit për të monitoruar rreziqet e ndërmarra nga banka dhe për përdorimin, zhvillimin dhe përmirësimin e metodave të administrimit të rrezikut. Banka e Shqipërisë rishikon dhe vlerëson PVBML-në, duke u bazuar përgjithësisht në raportin e PVBML-së dhe në dialogun me bankën mbi mjaftueshmërinë e likuiditetit.

Banka e Shqipërisë, në rastet kur nuk sigurohet zgjidhja apo përmirësimi i mangësive të PVBML-së, në bazë dhe për zbatim të dispozitave të ligjit për bankat dhe të kuadrit rregullativ në fuqi, ndërmerr masat mbikëqyrëse të nevojshme. Masat mbikëqyrëse mund të përfshijnë, ndër të tjera, vendimet e Bankës së Shqipërisë, kryesisht për vendosjen e kërkesave të veçanta (specifike) për likuiditet, duke përfshirë kufizime për mospërputhjet e maturimit ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve.

Për qëllime të përcaktimit të nivelit të duhur të kërkesave të veçanta për likuiditet, sipas pikës 2 të këtij neni, në bazë të rishikimit dhe vlerësimit të kryer, Banka e Shqipërisë vlerëson nëse është e nevojshme vendosja e një kërkesë të veçantë (specifike) likuiditeti për të monitoruar rreziqet e likuiditetit, ndaj të cilave është ose mund të ekspozohet një bankë, duke marrë në konsideratë elementet e mëposhtme:

- a) modelin e veçantë të biznesit të bankës;
- b) rregullimet, proceset dhe mekanizmat e bankës, të parashikuar në këtë udhëzues, veçanërisht strategjitë, politikat e procedurat për administrimin e likuiditetit;
- c) rezultatin e rishikimit dhe të vlerësimit të kryer nga Banka e Shqipërisë për PVBML-në; dhe
- d) rrezikun sistematik të likuiditetit që kërcënon integritetin e tregut financiar vendës ku operon banka.

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të kërkesave të këtij udhëzimi, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat.

Të fundit

Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij udhëzimi.

Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve, për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Hyrja në fuqi

Bankat, deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, marrin masat dhe krijojnë kushtet e nevojshme për zbatimin e kërkesave të udhëzimit, si dhe për paraqitjen e raportit të procesit të vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit në Bankën e Shqipërisë (Departamenti i Mbikëqyrjes) me të dhënat e fundvitit 2022 dhe sipas afatit të përcaktuar (31 mars 2023).

Ky udhëzim hyn në fuqi më 31 dhjetor 2022.

ANEKSI 1
STRUKTURA E RAPORTIT TË PVBML-së

1. Hyrje

- Modeli i biznesit që përfshin linjat e biznesit, filialet dhe shpërndarjen gjeografike.
- Të qenët ose jo bankë sistemike.
- Ndryshimet në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm, ku ka operuar banka gjatë vitit të kaluar.

- Gjithëpërfshirja dhe proporcionaliteti i PVBML-së, shoqëruar me argumente dhe sqarime.

2. Përmbledhje

- Konkluzionet e përgjithshme të rishikimit të PVBML-së, që përshkruajnë në çfarë mase banka është në përputhshmëri me rregulloret e likuiditetit, udhëzimet mbi administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe PVBML-në e miratuar nga Banka e Shqipërisë

- Çdo mangësi dhe përmirësim që propozohet të kryhet.
- Vlerësimi i çdo rezerve shtesë të likuiditetit që banka do të mbajë, për llogari të rreziqeve që nuk kapen nga RML-ja.

3. Raportimi i RML-së

3.1 Rezerva e likuiditetit

Në këtë seksion trajtohet përputhshmëria me kërkesat rregullative, që lidhen me pranueshmërinë e rezervës së likuiditetit.

3.2 Flukset dalëse

Në këtë seksion trajtohet përputhshmëria me kërkesat rregullatore, që lidhen me matjen e flukseve dalëse. Kjo përfshin përmbushjen e kërkesës për rikalibrimin e faktorëve të tërheqjes, duke marrë në konsideratë përvojën historike të bankës, ndryshimet në modelin e biznesit dhe ndryshimet në profilin e rrezikut të likuiditetit, që vijnë nga ana e pasiveve, nga zërat jashtë bilancit dhe nga ekspozimet ndaj rrezikut reputacional.

3.3 Flukset hyrëse

Në këtë seksion trajtohet përputhshmëria me kërkesat rregullatore, që lidhen me matjen e flukseve hyrëse, duke përfshirë nevojën për rikalibrim, duke marrë në konsideratë përvojën historike të bankës dhe çdo ndryshim në modelin e biznesit dhe në profilin e rrezikut të likuiditetit që vjen nga ana e aktiveve.

4. Vlerësimi i rrezikut të likuiditetit

4.1 Vlerësimi i nevojave të likuiditetit në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme

Në këtë seksion, bankat përshkruajnë profilin e tyre të likuiditetit në horizonte të përshtatshme kohore deri në 12 muaj, burimet dhe përdorimet mbi baza bruto dhe neto, dhe veprimet që ato ndërmarrin për të mbuluar këto nevoja likuiditeti, si në rrethana normale, edhe nën stres. Banka përshkruan edhe çdo rast kur parametri i RML-së nuk kap rreziqet e saj të likuiditetit, brenda 30 ditëve, dhe mënyrën se si do të administrohet ai rrezik.

4.2 Vlerësimi i rrezikut gjatë ditës (*intra-day*)

Në këtë seksion, bankat përshkruajnë mënyrën se si krijohet rreziku gjatë ditës, brenda biznesit të tyre, si pjesëmarrëse në sistemin e pagesave, oreksi/toleranca dhe qasja e tyre mbi administrimin e rrezikut të likuiditetit gjatë ditës (*intra-day*), për llogaritë e *cash*-it dhe letrave me vlerë, dhe për veprimtarinë e bankës (biznesin), si në kushte normale dhe të stresuara. Ato (bankat) përfshijnë edhe qasjen mbi *stress testing* dhe konkluzionet e tij.

4.3 Vlerësimi i rezervës së likuiditetit dhe i aftësisë kundërbalancuese

Në këtë seksion, bankat përshkruajnë procedurat për llogaritjen, kontrollin dhe monitorimin e rezervës së likuiditetit dhe aftësisë kundërbalancuese, si dhe efektivitetin e tyre në skenarë të

ndryshëm, të cilët përfshijnë skenarë që ndikojnë mbi likuiditetin e aktiveve dhe aftësinë kundërbalancuese.

5. Vlerësimi i rrezikut të brendshëm të financimit

5.1 Vlerësimi i rreziqeve të profilit të financimit të bankës

Në këtë seksion, bankat përshkruajnë strategjinë dhe oreksin/tolerancën ndaj rrezikut të financimit, si dhe profilin e këtij rreziku, burimet dhe përdorimet mbi baza bruto dhe neto.

5.2 Vlerësimi i rreziqeve të qëndrueshmërisë së profilit të financimit

Në këtë seksion, bankat analizojnë qëndrueshmërinë e detyrimeve brenda profilit të financimit dhe rrethanat në të cilat ato mund të bëhen të paqëndrueshme. Kjo mund të përfshijë zhvendosjet e tregut, ku përfshihen ndryshimet në vlerat e kolateralit, mospërputhje të tepërta të maturimeve, nivele të papërshtatshme të barrës apo të detyrimit mbi aktivin, përqendrimet (duke përfshirë kundërpartitë individuale apo të lidhura mes tyre apo monedhat e huaja).

5.3 Vlerësimi i aksesit në treg

Në këtë seksion, bankat analizojnë aksesin në treg dhe kërcënimet aktuale apo të ardhshme ndaj këtij aksesit, duke përfshirë ndikimin e çdo stresi afatshkurtër të likuiditetit apo ndikimin nga lajmet negative.

5.4 Vlerësimi i ndryshimit të pritshëm në rreziqet e financimit, bazuar mbi planin e financimit të bankës

Në këtë seksion, bankat vlerësojnë ndryshimin e pritshëm në rreziqet e financimit, bazuar mbi planin e financimit të bankës.

6. Vlerësimi i administrimit të rrezikut të likuiditetit dhe i rrezikut të financimit

6.1 Vlerësimi i strategjisë së rrezikut dhe i oreksit/tolerancës ndaj rrezikut

Në këtë seksion, bankat përshkruajnë oreksin/tolerancën ndaj rrezikut dhe strategjinë e rrezikut, mënyrën si janë konceptuar, miratuar, monitoruar dhe raportuar ato, dhe mënyrën se si ato janë komunikuar brenda bankës.

6.2 Kuadri organizativ, politikat dhe procedurat

Në këtë seksion, bankat përshkruajnë marrëveshjet e drejtimit dhe të administrimit, në lidhje me PVBML-në, së bashku me përfshirjen e organeve drejtuese (këshillit drejtues dhe drejtorisë). Ato përshkruajnë, gjithashtu, edhe kuadrin e rrezikut në përgjithësi dhe për sa u takon rreziqeve të likuiditetit dhe të financimit, burimet teknike dhe të stafit.

6.3 Identifikimi, matja, administrimi, monitorimi dhe raportimi i rrezikut

Në këtë seksion, bankat përshkruajnë kuadrin dhe sistemet e TI-së për identifikimin, matjen, administrimin dhe monitorimin e raportimit të brendshëm dhe të jashtëm të rreziqeve të likuiditetit dhe të financimit, duke përfshirë rrezikun ditor. Gjithashtu, përshkruhen edhe supozimet dhe metodologjitë e përdorura, si dhe evidentohen treguesit kyçë dhe përshkruhen flukset e brendshme të informacionit.

6.4 *Stress testing* specifik i likuiditetit të bankës

Në këtë seksion, bankat analizojnë kuadrin e brendshëm të *stress testing*, duke përfshirë procesin e përcaktimit dhe të administrimit të skenarëve, si dhe sfidat përkatëse, supozimet dhe përcaktimin e analizës së ndjeshmërisë, si dhe procesin e rishikimit, sfidat dhe rëndësinë për oreksin/tolerancën ndaj rrezikut. Procesi përmes të cilit prodhohen rezultatet e *stress test*-it dhe përfshihen në kuadrin e rrezikut dhe në planifikimin strategjik, si dhe procesi i rimëkëmbjes së likuiditetit shqyrtohen me kujdes. Rezultatet dhe konkluzionet analizohen sipas çdo faktori përcaktues me rëndësi të rrezikut.

6.5 Kuadri i kontrollit të brendshëm të rrezikut të likuiditetit

Në këtë seksion, bankat përshkruajnë kuadrin e tyre të kufijve dhe të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë kufijtë dhe kontrollet mbi rezervat e aktiveve likuide, si dhe përshtatshmërinë e strukturës së kufijve me oreksin/tolerancën ndaj rrezikut. Kuadri i transferimit të vendosjes së çmimeve përshkruhet, gjithashtu, në këtë seksion, si për shembull si është zhvilluar metodologjia, si është kontrolluar, monitoruar dhe rishikuar procesi, si dhe rezultatet që përcillen përmes

bankës për të përcaktuar sjelljet dhe për të mbështetur matjen e performancës dhe incentivat (stimujt) për biznesin.

6.6 Planet e emergjencës së likuiditetit

Në këtë seksion, bankat detajojnë politikat, procedurat dhe planet e veprimit për t'iu përgjigjur çrregullimeve të rënda në aftësinë e bankës për t'u vetëfinancuar. Planit është i njëjtë me atë që përmban plani i rimëkëmbjes së tyre dhe jepet si referencë apo përfshihet brenda dokumentit të PVBML-së.

6.7 Planet e financimit

Në këtë seksion, bankat ofrojnë planin e plotë të financimit, për të provuar se si do t'i mbështesin ato veprimtaritë e parashikuara (të biznesit), si në kushte normale, ashtu edhe në kushte stres, duke zbatuar çdo përmirësim të kërkuar në profilin e financimit dhe duke dhënë prova se nuk do të dëmtohen oreksi/toleranca ndaj rrezikut dhe parametrat kyç nga ndryshimet e planifikuara. Rreziqet ndaj planit diskutohen dhe, në rastet kur strategjia e financimit është e re, detajohen procedurat e zbatimit të saj.

7. Vlerësimi i çdo rezerve shtesë likuiditeti që banka do të mbajë për llogari të rreziqeve që nuk kapen nga RML-ja

Ky seksion përshkruan procesin e vlerësimit të çdo rezerve shtesë likuiditeti që banka do të mbajë për llogari të rreziqeve që nuk kapen nga RML-ja.

Gjithashtu, detajohen qartësisht faktorët që kontribuojnë në kërkesat shtesë dhe metodologjia për përcaktimin e kërkesave shtesë për likuiditet, si pasojë e ndërmarrjes së rreziqeve shtesë, në terma të një RML-je minimale më të lartë në përputhje me PVBML-në.

ANEKSI 2

KËRKESA MBI INFORMACIONIN MBI PVBML-në

1. Informacioni mbi administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të financimit

1.1 Dokumentimi i metodologjisë dhe i politikës

Banka e Shqipërisë, për të vlerësuar nëse banka ka një proces që siguron një kuadër të qëndrueshëm dhe specifik për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe të rrezikut të financimit, duke përfshirë procesin për identifikimin, matjen dhe kontrollin e rreziqeve të likuiditetit dhe të financimit, siguron marrjen nga ana e bankave të sa më poshtë:

a) përshkrimin e fushës së zbatimit të PVBML-së, duke përfshirë një pasqyrë dhe një arsyetim mbi çdo devijim nga fusha prudente e zbatimit të kërkesave për likuiditet, duke njohur edhe përjashtimet (*waivers*) e mundshme;

b) përshkrimin e hartimit të PVBML-së, që shpjegon marrëdhëniet ndërmjet të gjithë përbërësve të tij dhe duke ofruar arsyetim mbi mënyrën se si ai siguron që banka të ketë akses në likuiditet të mjaftueshëm;

c) kriteret e zbatuara nga banka për përzgjedhjen e faktorëve të konsiderueshëm përcaktues të rrezikut, për rrezikun e likuiditetit dhe të financimit, duke përfshirë përzgjedhjen e monedhave të huaja të konsiderueshme, për monitorimin e pozicionit të likuiditetit dhe të financimit;

d) kriteret e zbatuara nga banka për përzgjedhjen e mjeteve dhe supozimeve të përshtatshme për PVBML-në, të tilla si metoda e matjes dhe e parashikimit të flukseve të parasë aktuale dhe të ardhshme të aktiveve, pasiveve dhe zërave jashtë bilancit, përgjatë horizonteve të përshtatshme kohore.

1.2 Dokumentacioni operacional

Banka e Shqipërisë, për të vlerësuar zbatimin e plotë të një procesi që siguron se banka ka një kuadër të qëndrueshëm dhe specifik për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe të rrezikut të financimit, duke përfshirë një proces për identifikimin, matjen dhe kontrollin e rreziqeve të likuiditetit dhe të financimit, siguron marrjen nga ana e bankave të informacionit të mëposhtëm:

a) një vlerësim të flukseve të likuiditetit dhe pozicioneve të financimit brenda grupit, duke përfshirë çdo pengesë të mundshme ligjore ose rregullative për transferimin e likuiditetit brenda grupit bankar/financiar;

b) arsyetimin mbi përzgjedhjen e faktorëve të rëndësishëm përcaktues të rrezikut dhe një pasqyrë sasiore të këtyre faktorëve që përditësohet me një shpeshtësi të përshtatshme;

c) pasqyrë sasiore të profilit të financimit dhe të qëndrueshmërisë së tij në të gjitha monedhat e huaja të konsiderueshme;

d) evidencë të monitorimit të përputhshmërisë me kërkesat prudente minimale dhe ato shtesë, në lidhje me rrezikun e likuiditetit dhe të financimit, në përputhje me rregulloret për RML-në dhe RNFQ-në në fuqi, duke përfshirë parashikimin e përputhshmërisë me këto kërkesa, sipas skenarëve të ndryshëm, përgjatë një horizonti të përshtatshëm kohor dhe brenda fushës së zbatimit të PVBML-së.

2. Informacion mbi strategjinë e financimit

2.1 Metodologjia dhe dokumentacioni i politikës:

a) përshkrim i konfigurimit të përgjithshëm të planit të financimit, duke përfshirë burimet e financimit, maturitetet e mbetura, tregjet kyçe, produktet e përdorura etj.;

b) nëse është e përshtatshme, një dokument i politikës mbi sigurimin e pranisë në tregje, me qëllim që të sigurohet dhe të testohet në mënyrë të rregullt aksesit në treg dhe aftësia e bankës për të mbledhur fonde, nëse është relevante;

c) nëse është e përshtatshme, një dokument i politikës mbi rrezikun e përqendrimit të financimit, duke përfshirë edhe parimet për matjen dhe monitorimin e korrelacionit ndërmjet burimeve të financimit dhe të lidhjes ekonomike ndërmjet depozituesve dhe ofruesve të tjerë të likuiditetit;

d) nëse është e përshtatshme, një politikë mbi financimin në monedha të huaja, duke përfshirë supozimet më të rëndësishme, në lidhje me disponueshmërinë dhe konvertueshmërinë e këtyre monedhave të huaja.

2.2 Dokumentacioni operacional:

a) plani aktual i financimit;

b) një pasqyrë sasiore e karakteristikave, të tilla si vëllimet, çmimet dhe oreksi ndaj rrezikut i investitorit të fondeve të mbledhura kohët e fundit, si dhe një analizë e realizueshmërisë së ekzekutimit të planit të financimit, duke marrë në konsideratë (ndryshimet në) luhatshmërinë e tregut;

c) një kuadër i vlerësuar mbi bazën e perspektivës (*forward-looking*) mbi ecurinë (e pritshme) të pozicionit të financimit në një horizont kohor në perspektivë (*forward-looking*);

d) një vlerësim i pozicionit të financimit dhe i rrezikut të financimit, pas ekzekutimit të planit të financimit;

e) informacion mbi *back-testing* të planit të financimit.

3. Informacion mbi strategjinë në lidhje me rezervën e likuiditetit dhe administrimin e kolateralit

3.1 Dokumentimi i metodologjisë dhe politikës

Bankat paraqesin në PVBML, në lidhje me rezervën e likuiditetit dhe strategjinë e administrimit të kolateralit, informacionin e mëposhtëm:

a) metodologjinë e tyre për përcaktimin e madhësisë së brendshme minimale të rezervës së likuiditetit, duke përfshirë përkufizimin e bankës për aktivet likuide, kriteret që banka zbaton për përcaktimin e vlerës së likuiditetit të aktiveve likuide dhe kufijtë që lidhen me përqendrimin dhe karakteristikat e tjera të rrezikut të aktiveve likuide;

b) dokumentin e politikës mbi administrimin e kolateralit, duke përfshirë parimet, në lidhje me vendndodhjen dhe transferueshmërinë e kolateralit, ashtu si edhe rolin e tyre, në lidhje me përmbushjen e kërkesave minimale prudente;

c) dokumentin e politikës mbi barrën apo detyrimin mbi aktivin, duke përfshirë parimet për matjen dhe monitorimin, si të aktiveve të ngarkuara me barrë apo detyrim, ashtu edhe të aktiveve

të lira, dhe duke lidhur kuadrin e kufijve dhe të kontrolleve, në lidhje me barrën apo detyrimin mbi aktivin me oreksin/tolerancën ndaj rrezikut (të likuiditetit dhe të financimit) të bankës;

d) parimet për testimin e supozimeve që lidhen me vlerën e likuiditetit dhe kohën e nevojshme për të shitur ose riblerë aktivet që përfshihen në rezervën e aktiveve likuide;

e) dokumentin e politikës mbi rrezikun e përqendrimit të likuiditetit në rezervën e likuiditetit, duke përfshirë parimet për matjen dhe për monitorimin e çdo humbjeje potenciale të likuiditetit të disponueshëm, që vjen si pasojë e këtij përqendrimi.

3.2 Dokumentacioni operacional

Bankat, për evidentimin e zbatimit të strategjisë, në lidhje me rezervat e likuiditetit dhe administrimin e kolateralit, paraqesin sa më poshtë:

a) nivelin minimal të aktiveve likuide që konsiderohen të përshtatshme për të përmbushur kërkesat e brendshme;

b) nivelin e rezervës aktuale të likuiditetit, duke përfshirë shpërndarjen e saj sipas produkteve, monedhave të huaja, kundërpasive, rajoneve/grupeve të subjekteve (entiteteve) etj.;

c) parashikimet e ecures së nivelit minimal të brendshëm të kërkuar të aktiveve likuide dhe të aktiveve likuide të disponueshme gjatë horizonteve kohore të përshtatshme, në kushtet normale të veprimtarisë dhe ato të stresuara;

d) pasqyrën sasiore dhe analizën e niveleve aktuale dhe të parashikuara të aktiveve të ngarkuara me barrë apo detyrim (barrësuar), duke përfshirë hollësi të aktiveve, si të ngarkuara me barrë apo detyrim, ashtu edhe atyre të lira, të cilat mund të përdoren për të gjeneruar likuiditet;

e) vlerësimin e kohës që kërkohet për konvertimin e aktiveve likuide në likuiditet të përdorshëm drejtpërsëdrejti, duke marrë në konsideratë pengesat ligjore, operationale apo prudente ndaj përdorimit të aktiveve likuide për të mbuluar flukset dalëse të *cash*-it;

f) analizën e testimit të supozimeve, në lidhje me vlerën e likuiditetit dhe kohën e nevojshme për të shitur ose riblerë aktivet që përfshihen në rezervën e aktiveve likuide.

4. Informacion mbi mekanizmin e shpërndarjes kosto-përfitime

4.1 Dokumentimi i metodologjisë dhe politikës

Bankat, në lidhje me konfigurimin e mekanizmit të shpërndarjes kosto-përfitime të likuiditetit, ofrojnë sa më poshtë:

a) përshkrimin e mekanizmit të shpërndarjes kosto-përfitime të likuiditetit, ashtu si edhe kriteret për përzgjedhjen e elementeve të likuiditetit dhe të financimit, të cilat sigurojnë se të gjitha përfitimet dhe kostot që duhen janë marrë në konsideratë, ashtu si edhe çdo rregullim i shpeshtësisë së ndryshimit të çmimeve;

b) përshkrimin e ndërlidhjeve mes mekanizmit të shpërndarjes kosto-përfitime të likuiditetit, administrimit të rrezikut dhe administrimit në tërësi të bankës;

c) për bankat të cilat kanë mekanizma të transferimit të çmimit të likuiditetit, Banka e Shqipërisë siguron që informacioni i parashikuar në paragrafin e mësipërm të përfshijë, gjithashtu, përshkrimin e konfigurimit dhe të funksionimit të transferimit të çmimit të likuiditetit, dhe, në veçanti, të ndërlidhjeve mes transferimit të çmimit të likuiditetit dhe vendimmarrjes strategjike, ashtu si vendimmarrjes së njësisë operuese (*front office*) mbi prodhimin e aktiveve dhe pasiveve.

4.2 Dokumentacioni operacional

Bankat, për evidentimin e shpërndarjes kosto-përfitime të zbatimit të mekanizmit të likuiditetit, paraqesin sa më poshtë:

a) përshkrimin e mekanizmit aktual të shpërndarjes kosto-përfitime të likuiditetit dhe një pasqyrë sasiore të kalibrimit të tij aktual (p.sh., kurbat e normave të interesit, normat e brendshme referencë për kategoritë kryesore të aktiveve dhe pasiveve në përdorim etj.);

b) përshkrimin e mekanizmit aktual të integritetit të shpërndarjes kosto-përfitime të likuiditetit në matjen e përfitueshmërisë për gjenerimin e aktiveve dhe pasiveve të reja, si në bilanc ashtu edhe jashtë bilancit;

c) përshkrimin e mekanizmit aktual të integritetit të shpërndarjes kosto-përfitime të likuiditetit në matjen e performancës, të ndarë, aty ku nevojitet, sipas linjave/njësive të biznesit apo rajoneve të ndryshme.

Për bankat, të cilat kanë mekanizma të transferimit të çmimit të likuiditetit, informacioni i parashikuar në paragrafin e mësipërm duhet të përfshijë, gjithashtu, funksionimin e transferimit të çmimit të likuiditetit dhe, në mënyrë të veçantë, marrëdhëniet ndërmjet transferimit të çmimit të likuiditetit dhe normave bazë të rrezikut.

5. Informacion mbi administrimin e rrezikut të likuiditetit gjatë ditës

5.1 Dokumentimi i metodologjisë dhe politikës

Bankat, nëse është e përshtatshme, përfshijnë në PVBML informacionin e mëposhtëm, në lidhje me konfigurimin e administrimit të rrezikut të likuiditetit gjatë ditës:

a) përshkrimin e kriterëve dhe të mjeteve për matjen dhe monitorimin e rreziqeve të likuiditetit gjatë ditës;

b) përshkrimin e procedurave të përshkallëzimit për qëllimin e mungesave të likuiditetit gjatë ditës, që sigurojnë se pagesat e caktuara dhe detyrimet e shlyerjeve përmbushen në kohën e duhur, si në kushte normale të veprimtarisë dhe në ato të stresuara.

5.2 Dokumentacioni operacional

Bankat, nëse është e përshtatshme, paraqesin në PVBML informacionin e mëposhtëm, lidhur me zbatimin e administrimit të rrezikut të likuiditetit gjatë ditës:

a) nivelin (sasior) të rrezikut të likuiditetit gjatë ditës, brenda vitit të kaluar, me një frekuencë të përshtatshme;

b) numrin total të pagesave të munguara dhe një pasqyrë me shpjegimet përkatëse për pagesat materiale të munguara apo të detyrimeve materiale që banka nuk ka arritur të përmbushë në kohën e duhur.

6. Informacion mbi *stress testing* të likuiditetit

6.1 Dokumentimi i metodologjisë dhe politikës

Bankat, në lidhje me konfigurimin e *stress testing* të likuiditetit, paraqesin në PVBML informacionin e mëposhtëm:

a) përshkrimin e skenarëve të ashpër që zbatohen dhe të supozimeve që konsiderohen në *stress testing* të likuiditetit, duke përfshirë çdo zë me rëndësi, të tillë si numri i skenarëve të përdorur, shtrirja, shpeshësia e raportimit të brendshëm pranë organeve drejtuese (*management body*), faktorët përcaktues të rrezikut (makro dhe specifikë (*idiosyncratic*), horizontet kohore që zbatohen dhe, kur duhet, ndarjen sipas monedhave të huaja/rajoneve/njësive të biznesit;

b) përshkrimin e kriterëve për kalibrimin e skenarëve, duke përzgjedhur horizontet kohore të përshtatshme (përfshirë horizontin ditor, nëse duhet), përcaktimin sasior të ndikimit të *stress*-it mbi vlerën e likuiditetit të aktiveve likuide (të rezervës së likuiditetit) etj.

6.2 Dokumentacioni operacional

Bankat, për evidentimin e zbatimit të plotë të *stress testing* të likuiditetit, paraqesin sa më poshtë:

a) rezultatin sasior të *stress test*-eve, duke përfshirë një analizë (faktorët kryesorë përcaktues) të këtij rezultati dhe një shqyrtim të qartë të rëndësisë së rezultatit për kufijtë e brendshëm, rezervat e likuiditetit, raportimin, modelimin dhe oreksin/tolerancën ndaj rrezikut;

b) analizën sasiore dhe cilësore të rezultateve të *stress testing* mbi profilin e financimit.

7. Informacion mbi planin e emergjencës së likuiditetit

7.1 Dokumentimi i metodologjisë dhe i politikës

Bankat, lidhur me konfigurimin e planifikimit të emergjencës së likuiditetit, përfshijnë në raportin e PVBML-së, sa më poshtë:

a) përshkrimin e linjave të përgjegjësisë për hartimin, monitorimin dhe ekzekutimin e planit të emergjencës së likuiditetit;

b) përshkrimin e strategjive për adresimin e mungesave të likuiditetit, në situata emergjence;

c) përshkrimin e një instrumenti për të monitoruar kushtet e tregut, të cilat u lejojnë bankave të përcaktojnë në kohën e duhur, nëse nevojitet përshkallëzimi dhe/ose ekzekutimi i masave;

d) përshkrimin e procedurave të testimit, nëse janë të disponueshme (siç janë shembujt e shitjeve të llojeve të reja të aktiveve, vendosja e kolateralit në Bankën e Shqipërisë etj.).

7.2 Dokumentacioni operacional

Bankat, lidhur me zbatimin e planeve të emergjencës së likuiditetit, paraqesin në raportin e PVBML-së, sa më poshtë:

- a) planin aktual të emergjencës së likuiditetit;
- b) informacion mbi veprimet e mundshme të drejtimit, duke përfshirë vlerësimin e realizueshmërisë së tyre dhe aftësisë për të gjeneruar likuiditet, nën skenarë të ndryshëm të stresit;
- c) këndvështrimin e drejtimit mbi implikimet e të gjitha deklaratave publike të lidhura me likuiditetin, të bëra nga banka, për realizueshmërinë dhe kohën e përshtatshme të veprimeve të drejtimit, të përfshira në planin e emergjencës së likuiditetit;
- d) analizën e fundit të testimit, duke përfshirë konkluzionet mbi realizueshmërinë e veprimeve të drejtimit, të përfshira në planin e emergjencës së likuiditetit;
- e) përshkrimin e këndvështrimit të brendshëm mbi ndikimin e kryerjes së veprimeve të drejtimit të përfshira në planin e emergjencës së likuiditetit, p.sh., mbi aksesin që ka banka në tregjet me rëndësi dhe mbi qëndrueshmërinë e përgjithshme të profilit të saj të financimit, në periudha afatshkurtra dhe afatgjata.

8. Dokumentacioni mbështetës

Bankat, përveç informacionit të paraqitur në pikat 1–7 të këtij aneksi 2, paraqesin të gjithë informacionin e duhur mbështetës, duke përfshirë minutat e takimeve përkatëse të komiteteve dhe të organeve drejtuese (*management body*), që evidentojnë konfigurimin dhe zbatimin e qëndrueshëm të PVBML-së dhe, në mënyrë të veçantë:

- a) miratimin e konfigurimit të përgjithshëm të PVBML-së;
- b) miratimin e elementeve kyçe të PVBML-së, të tilla si plani i financimit, plani i emergjencës së likuiditetit, mekanizmi i shpërndarjes kosto-përfitime të likuiditetit, supozimet e *stress-test*-eve dhe konkluzionet mbi rezultatet, oreksi/toleranca specifike ndaj rrezikut të likuiditetit dhe të financimit, madhësia dhe përbërja e synuar e rezervave të aktiveve likuide etj.;
- c) evidenca të diskutimeve mbi (ndryshimet në) profilin e rrezikut të likuiditetit dhe të financimit, thyerjet e kufijve etj., duke përfshirë vendimet mbi veprimet e drejtimit ose vendimin e qartë për të mos ndërmarrë asnjë veprim;
- d) shembuj të vendimeve të rëndësishme në komitetet për miratimin e produkteve të reja, duke evidentuar, nëse është e mundur, përdorimin e transferimit të çmimit të likuiditetit dhe këndvështrimet mbi rrezikun të përfshira në këto vendime;
- e) evidenca të diskutimit të analizës së realizueshmërisë së planit të financimit, bazuar në (ndryshimet në) thellësinë dhe luhatshmërinë e tregut;
- f) evidenca të vendimeve mbi veprimet e drejtimit, që lidhen me rrezikun ditor të likuiditetit, pas përshkallëzimi të brendshëm, për shkak të ngjarjeve ditore të likuiditetit;
- g) evidenca të diskutimit të rezultatit të *stress test*-eve të likuiditetit dhe të vendimit mbi çdo (mos)veprim të drejtimit;
- h) evidenca të diskutimit mbi testimin e rregullt të planit të emergjencës së likuiditetit dhe mbi vendimet lidhur me rregullimin e veprimeve të drejtimit, që renditen në planin e emergjencës së likuiditetit;
- i) vendimin lidhur me madhësinë dhe përbërjen e rezervës së aktiveve likuide;
- j) evidenca të diskutimit, lidhur me testimin e vlerës së likuiditetit dhe të kohës së kërkuar për të shitur apo për të riblerë aktivet e përfshira në rezervën e aktiveve likuide;
- k) nëse është e mundur, vetëvlerësimet e brendshme, nëpërmjet të cilave bankat mund të justifikojnë nivelin e përputhshmërisë së tyre me kriteret e publikuara rregullatore mbi administrimin e rrezikut dhe kontrollin që ndikojnë PVBML-në e bankës.